DVV International

Arsim për të gjithë. Në mbarë botën
Gjatë gjithë jetës.

Udhëzime për trajnerët
Moduli 1: Të qasurit ndaj arsimit për të rritur

Deutsches Institut für Erwachsenenbildung
Leibniz-Zentrum für Lebenslanges Lernen

Botuar nga:

Institut für Internationale Zusammenarbeit
des Deutschen Volkshochschul-Verbandes e.V. (DVV International)
Obere Wilhelmstraße 32, 53225 Bonn
Republika Federale e Gjermanisë
Tel.: +49 (0) 228-97569-0, Fax: +49 (0) 228-97569-55
info@dvv-international.de, www.dvv-international.de

Deutsches Institut für Erwachsenenbildung
Leibniz-Zentrum für Lebenslanges Lernen e.V. (DIE)
Heinemannstraße 12-14, 53175 Bonn
Republika Federale e Gjermanisë
Tel.: +49 (0) 228-3294-0, Fax: +49 (0) 228-3294-399
info@die-bonn.de, www.die-bonn.de

© 2016 DVV International, DIE

Autor:
Prof. Dr. Elena Rizova

Përmbajtja

Hyrje 0

TEMA 1: TË KUPTUARIT E SHUMËLLOJSHMËRISË DHE DIVERSITETIT TË ARSIMIT PËR TË RRITUR 0

1.1 Çka është arsimi për të rritur? 1

1.2 Rëndësia dhe funksionet e arsimit dhe të nxënit të të rriturve 5

Tabela nr. 2: Katër shtyllat e të nxënit sipas UNESCO-s 5

1.3 Pjesëmarrja aktive në arsimin për të rritur në kontekstin e të nxënit gjatë gjithë jetës 8

TEMA 2: KONCEPTET KYÇE ANDRAGOGJIKE DHE PEDAGOGJIKE 11

2.1. Të nxënit përkundrejt arsimit 12

2.2. Dallimet midis mësimdhënies për fëmijë dhe për të rritur 15

2.3. Tiparet kyçe të terminologjisë bazë arsimore 17

TEMA 3: ARSIMI PËR TË RRITUR NË KONTEKST KOMBËTAR DHE GLOBAL 23

3.1 Politikat ndërkombëtare të arsimit për të rritur 24

3.2 Sfidat dhe treguesit globalë në arsimin për të rritur 28

3.3 Arsimi për të rritur në kontekstin kombëtar 32

TEMA 4: ARSIMI PËR TË RRITUR SI PROFESION DHE ROLI I ARSIMTARIT PËR TË RRITUR 36

4.1 Arsimi për të rritur si profesion 37

4.2 Kompetencat e arsimtarit për të rritur 41

4.3 Reflektime për rolin e vet në arsimin për të rritur 44

Literatura e përdorur dhe e rekomanduar 46

Hyrje

Ky Doracak është punuar për përdorimin praktik nga praktikuesit e arsimit për të rritur (trajnerë, arsimtarë, instruktorë, etj.). Qëllimi i tij kryesor është t'u ndihmojë arsimtarëve t'i adresojnë shtyllat e arsimit dhe të nxënit të të rriturve, rëndësinë e arsimit për të rritur për rritjen sociale dhe personale, si dhe ofron zgjidhje didaktike dhe metodike për përmbajtjen e përshkruar në Modulin 1 të Curriculum globALE me titull: Të qasurit ndaj arsimit për të rritur.

Të kuptuarit e arsimit për të rritur dhe diversitetit të tij për sa u përket formave dhe zbatimit, funksioneve të arsimit për të rritur si dhe rëndësisë së arsimit për të rritur për zhvillimin dhe rritjen shoqërore, ekonomike dhe personale, janë një nga gjërat më të rëndësishme që duhet të dinë arsimtarët e të rriturve kur punojnë me të rriturit. Ky Modul ofron këndvështrimin e përgjithshëm të koncepteve arsimore pedagogjike dhe andragogjike, si dhe ndryshimin mes rrugëve të mësimdhënies dhe të nxënit për të rritur dhe fëmijë. Përmes përmbajtjes së Modulit, pjesëmarrësit do të kuptojnë terminologjinë themelore në punën arsimore me nxënës të rritur (kompetencat, qëllimet e të nxënit, rezultatet e të nxënit, kualifikimet, profesionet, etj.) dhe politikat ndërkombëtare të arsimit për të rritur të përshkruar në dokumentet evropiane dhe ndërkombëtare të organizatave referente (UNESCO, OSBE, KE, etj.), sfidat globale me të cilat përballen arsimi për të rritur dhe shoqëritë bashkëkohore në shekullin XXI, si dhe kontekstin kombëtar të arsimit për të rritur. Përmbajtja adreson shumëllojshmërinë e punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur, si dhe kompetencat që posedojnë profesionistët e arsimit për të rritur. Pasi të njihen me sa më lart, nxënësit duhet të jenë në gjendje ta kuptojnë dhe të reflektojnë për rolin e tyre në sistemin e arsimit për të rritur.

Doracaku përmban katër kapituj kryesorë, të cilët janë në përputhje me temat e modulit të parë të Curriculum globALE, të paraqitura në Tabelën në vijim.

Grafiku nr. 1: Përmbajtja e Doracakut



Brenda çdo teme jepet një strukturë metodike për përmbajtjen e temës:

- përshkrim i shkurtër tematik, me synime dhe rezultate;
- nën-temat me hyrje të shkurtër teorike dhe sugjerime dhe ide didaktiko-metodike (shembull i skenarit për realizimin e nën-temës ose shembuj të detyrave);
- Sugjerime për ide të provimit dhe pyetje dhe sugjerime për punën individuale.

Ky Doracak përbën mbështetje adragogjiko-didaktike për zbatimin e modulit të parë të Curriculum globALE, si vijon:

- Ofron bazat teorike të secilës temë, si një lloj "udhërrëfyesi" për zbatimin e përmbajtjes së tij për trajnerët;
- Propozon zgjidhje didaktike dhe modele të zbatimit të disa nën-temave;
- Jep udhëzime dhe këshilla të shumta për trajnerët, në lidhje me zgjedhjen e metodave të punës, kohën e caktuar për temë të caktuar, krijimin e pyetjeve të provimeve, udhëzimin e nxënësve se si të bëjnë punën individuale, përdorimin e literaturës shtesë, etj.

Kërkesat minimale për trajnimin për Modulin 1: Të qasurit ndaj arsimit për të rritur

1. Të trajnuarit reflektojnë për **pikëpamjet e tyre për njerëzimin, moshën madhore dhe të rriturit**, si dhe për arsimin dhe të nxënit, dhe reflektojnë për mënyrën si shihen këto koncepte në shoqërinë/kulturën/vendin e tyre në përgjithësi.
2. Të trajnuarve u prezantohen **konceptet kyçe teorike pedagogjike** (të nxënit, arsimi, socializimi, njohuritë, kompetencat, shkathtësitë, kualifikimi) dhe i lidhin këto me kontekstin e tyre të NARr-it (të nxënit dhe arsimi për të rritur).
3. Të trajnuarve u prezantohen **struktura dhe tiparet kyçe të arsimit për të rritur në vendin e tyre**: ofruesit kryesorë (llojet e tyre); ministritë përgjegjëse; strukturat e financimit dhe qeverisjes; nevojat e të nxënit të popullatës; modelet e pjesëmarrjes Të dhënat dhe informacionet krahasuese ndërkombëtare prezantohen sipas nevojës, në mënyrë që të trajnuarit të bëhen më të vetëdijshëm për specifikat e vendit të tyre në lidhje me NARr-in dhe alternativat e mundshme.
4. Të trajnuarit analizojnë dhe trajtojnë në mënyrë kritike synimet, objektivat dhe zhvillimet e **politikave aktuale arsimore** në vendin e tyre në lidhje me të nxënit e të rriturve/të nxënit gjatë gjithë jetës. Ata i lidhin këto zhvillime me kontekstin e tyre të NARr-it.
5. Të trajnuarve u prezantohet dhe përvetësojnë një **pasqyrë të gjerë të zhvillimeve të politikave arsimore ndërkombëtare/globale** (p.sh. të promovuara nga BE, OECD, UNESCO) të cilat ofrojnë sfondin për zhvillimet e tyre kombëtare. Ata diskutojnë sesi ndikojnë këto zhvillime ndërkombëtare në kontekstin e tyre.
6. Të trajnuarit reflektojnë mbi (grupe të ndryshme) **vlerash** që **shoqërohen me të nxënit dhe mësimdhënien për të rritur**. Ata reflektojnë për sistemin e tyre profesional të vlerave, për **rolin e tyre si mësimdhënës/trajnerë të të rriturve** dhe për mundësitë dhe kufizimet që përfshin ky rol.

TEMA 1: TË KUPTUARIT E SHUMËLLOJSHMËRISË DHE DIVERSITETIT TË ARSIMIT PËR TË RRITUR

Tema e parë është trajtimi i fushës më të gjerë të arsimit për të rritur, e cila mund të vrojtohet nga këndvështrime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme. Ajo ka disa nën-tema specifike të cilat janë përqendruar në elemente të ndryshme të Temës kryesore dhe janë paraqitur në Tabelën 2 të Doracakut me përshkrime të synimeve të të nxënit dhe rezultateve të të nxënit. Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe njohurive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënit. Koha optimale për zbatimin e kësaj teme është 1 ditë.

Qëllimi kryesor i kësaj Teme është të kuptohet arsimi për të rritur si një nën-sistem integral arsimor në shoqëri dhe diversiteti i tij në aspektin e formave dhe zbatimit, si dhe rëndësia e tij për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe personal.

Tabela 1: Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës: **TË KUPTUARIT E SHUMËLLOJSHMËRISË DHE DIVERSITETIT TË ARSIMIT PËR TË RRITUR**

Synimi i të nxënit të zbatimit të temës: Të kuptuarit e arsimit për të rritur dhe diversitetit të tij për sa u përket formave dhe zbatimit, të kuptuarit e funksioneve të arsimit për të rritur si dhe rëndësisë së arsimit për të rritur për zhvillimin dhe rritjen shoqërore, ekonomike dhe personale. *Rezultati i përgjithshëm i të nxënit:* Pas zbatimit të kësaj teme, nxënësit e njohin diversitetin dhe shumëllojshmërinë e formave të arsimit dhe të nxënit të të rriturve, kuptojnë funksionet themelore të arsimit për të rritur dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur.		
Nën-tema	**Synimi**	**Rezultati**
1. Çka është arsimi për të rritur?	Hyrje në nocionin "arsimi për të rritur" dhe "andragogji", rrënjët dhe rëndësia e tyre historike, si dhe faktorët që ndikojnë në arsimin për të rritur.	Nxënësit do të dinë të bëjnë dallimin mes termave "arsimi për të rritur" dhe "andragogji", ata do të kuptojnë rrënjët historike dhe faktorët që ndikojnë në arsimin për të rritur.
2. Rëndësia dhe funksionet e arsimit dhe të nxënit të të rriturve	Të kuptuarit e rëndësisë dhe funksioneve të arsimit dhe të nxënit të të rriturve	Nxënësit do të dinë dhe kuptojnë rëndësinë e arsimit dhe të nxënit të të rriturve, si dhe funksionet kryesore: sociale, ekonomike dhe personale.
3. Pjesëmarrja aktive në arsimin për të rritur në kontekstin e të nxënit gjatë gjithë jetës	Prezantimi i rëndësisë së pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur si pjesë e procesit të të nxënit gjatë gjithë jetës.	Nxënësit do të njohin dhe pranojnë nocionin e të nxënit gjatë gjithë jetës si koncept, dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur.

1.1 Çka është arsimi për të rritur?

Nocioni i arsimit për të rritur nuk është një konstrukt arsimor i ri dhe modern, por është dukuri e rëndësishme historike dhe civilizuese. Historia dhe rrënjët e arsimit për të rritur mund të gjenden edhe në periudhën e Greqisë antike, ku filozofë eminentë përcaktuan rëndësinë e të nxënit gjatë gjithë jetës (Sokrati, Aristoteli, Herakliti, Seneka), të zhvilluara më vonë nga social-utopistët (Komensky, Krupska, etj.). Arsimi për të rritur përparoi gjatë kalimit nga shekulli XVIII në shekullin XIX me shfaqjen e revolucionit industrial, kur ishte e domosdoshme nevoja për punëtorë me kualifikim të lartë. Këtu u krijua baza institucionale për arsimin për të rritur me shfaqjen e Institutit të Mekanikës, kolegjeve të punëtorëve dhe shoqatave arsimore, zgjerimeve të universiteteve, shkollave me konvikte për të nxënit e të rriturve, arsimin me korrespodencë dhe universitetet civile.

Arsimi për të rritur së shpejti do të bëhet një nga instrumentet më domethënës për emancipimin dhe përparimin shoqëror, si përgjigje ndaj rrethanave të reja të jetës në shoqëritë bashkëkohore të bazuara në dije. Sot dihet mirë se arsimi për të rritur konsiderohet si përvetësim i rëndësishëm i civilizimit me synime dhe detyra të gjera, që është ndër prioritetet më të larta kombëtare.

Përkundër të gjitha funksioneve të larmishme që arsimi për të rritur ka në vende të ndryshme në Evropë dhe në botë, ai mund të vërehet si veprimtari e konceptuar shkencërisht e orientuar drejt plotësimit të shumëllojshmërisë së nevojave arsimore. Ky lloj të kuptuari i arsimit për të rritur, i bën fushat dhe përmbajtjet e tij të jenë më të shtrira dhe më të gjera në kontekstin e përparimit teknologjik dhe civilizues dhe roleve dhe sfidave të reja njerëzore në kushtet e shoqërisë bashkëkohore.

Fondacioni Shkencor i Andragogjisë

Zhvillimi i termin “andragogji” u bë nga Alexander Kapp (1833) një mësimdhënës gjerman i shkollës së mesme. Sipas tij andragogjia është arsim për moshën e njeriut duke përfshirë vetë-reflektimin, dhe me edukimin e karakterit këto janë vlerat e para në jetën e njeriut. Modelet në andragogji përfshinin personalitetin e brendshëm, subjektiv, dhe kompetencat e jashtme, objektive, dhe se të nxënit ndodh jo vetëm përmes mësimdhënësve, por edhe përmes vetë-reflektimit dhe përvojës jetësore, gjë që e bën atë më shumë sesa mësimdhënie për të rritur. Eduard Lindeman (1926) e solli andragogjinë në SHBA nga Lëvizja për Arsimin e Punëtorëve në Gjermani. Ai vuri bazat më të hershme në SHBA për zbatim madhor praktik të andragogjisë si metodë për të nxënit e të rriturve. Edhe termi u la në heshtje për shumë vite, Malcolm Knowles (1970) ndihmoi në hedhjen e themeleve në SHBA. Knowles (1995) dha shprehjen më të artikuluar dhe kuptimin më të plotë të andragogjisë nga këndvështrimi amerikan. Struktura e teorisë përbëhet nga dy themele konceptuale: Teoria e të nxënit dhe teoria e dizajnit.

Teoria e të nxënit bazohet tek të rriturit dhe dëshira e tyre për t’u bërë dhe/ose për t’u shprehur si qenie njerëzore të afta, dhe ka gjashtë komponentë: (a) Të rriturit duhet të dinë një arsye që ka kuptim për ta, për çdo gjë që duhet të mësojnë, (b) Ata kanë një nevojë të thellë për të qenë të vetë-drejtuar dhe të marrin përgjegjësinë për veten e tyre, (c) Të rriturit hyjnë në një aktivitet të të nxënit me një cilësi dhe vëllim të përvojës që është burim për të nxënit e tyre dhe të të tjerëve, (d) Ata janë të gatshëm të mësojnë kur provojnë një nevojë për të ditur, ose jenë në gjendje ta bëjnë këtë, për ta plotësuar më efektivisht ndonjë aspekt të jetës së tyre, (e) Orientimi i të rriturve për të nxënit është rreth situatave të

jetës, të cilat janë të drejtuara nga detyra, çështja ose problemi, për të cilat ata kërkojnë zgjidhje, (f) Të rriturit motivohen më shumë nga brenda sesa nga jashtë[1].

D. Savicevic (1991) siguroi një konsideratë kritike të koncepteve andragogjike në dhjetë vende evropiane - pesë perëndimore (Gjermani, Francë, Holandë, Britani, Finlandë) dhe pesë lindore (Rusi, Çeki, Sllovaki, Poloni, Hungari, Jugosllavi). Ky krahasim tregoi rrënjë të përbashkëta, por rezulton në pesë shkolla të ndryshme të mendimit: (1) Nëse andragogjia është paralele me ose e varur nga pedagogjia në shkencën e përgjithshme të arsimit; (2) Nëse agologjia (në vend të andragogjisë) kuptohet si një lloj i shkencës integruese e cila jo vetëm që studion procesin e arsimit dhe të nxënit por edhe format e tjera të udhëzimit dhe orientimit; (3) nëse andragogjia përcakton se si mësimdhënësit dhe studentët duhet të sillen në situata arsimore dhe të të nxënit; (4) mundësia e themelimit të andragogjisë si shkencë është e hedhur poshtë; dhe, (5) janë bërë përpjekje për ta themeluar andragogjinë si një disiplinë shkencore mjaft e pavarur. Për më tepër, ai preferonte shkollën e pestë të mendimit, pasi lloji i hulumtimit që ai po kryente synon përcaktimin e origjinës dhe zhvillimin e andragogjisë si një disiplinë, lënda e së cilës është studimi i arsimit dhe të nxënit të të rriturve në të gjitha format e shprehjes.

Savicevic (1999b) sugjeron se andragogjia përkufizohet si një disiplinë shkencore, e cila merret me problemet që lidhen me zhvillimin e burimeve njerëzore dhe arsimin për të rritur dhe të nxënit në të gjitha manifestimet dhe shprehjet e tij, qofshin ato formale apo informale, të organizuara apo të vetë-drejtuara, me fushëveprimin e hulumtimit që mbulon pjesën më të madhe të jetës së një personi. Kjo është e lidhur me avancimin e kulturës dhe kryerjen e: roleve dhe detyrave profesionale, përgjegjësive familjare, funksioneve sociale ose komunitare, dhe përdorimin e kohës së lirë. Të gjitha këto fusha janë pjesë e domenit të punës të praktikës së zhvillimit të burimeve njerëzore dhe arsimit për të rritur. Mund të thuhet se është krijuar një lidhje e qartë nga hulumtimi në praktikën e andragogjisë, me andragogjinë si arti dhe shkenca që u ndihmon të rriturve për të mësuar dhe që studion zhvillimin e burimeve njerëzore dhe teorisë, proceseve dhe teknologjisë së arsimit për të rritur.

Faktorët që ndikojnë në arsimin për të rritur

Në shoqërinë bashkëkohore të bazuar në njohuri, individët janë në gjendje të mësojnë vazhdimisht dhe të përmirësojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre, gjë që thekson rëndësinë e arsimit dhe të nxënit të të rriturve. Nga ky këndvështrim, janë tre faktorë globalë që ndikojnë në arsimin për të rritur: faktori demografik, social dhe teknologjik.

Faktori demografik ka ndikimin e tij të drejtpërdrejtë në masën, format dhe përmbajtjen në arsimin për të rritur. Rritja e përqindjes së popullsisë së rritur dhe të moshuar në statistikat e përgjithshme të popullsisë nuk është vetëm karakteristikë e vendeve të zhvilluara, por edhe për vendet në zhvillim. Në Evropë për shembull, sipas hulumtimeve bashkëkohore në fushën e demografisë, 80% e popullsisë janë së rritur, ndërsa të rinjtë nën 16 vjeç përbëjnë vetëm 20%. Kjo është dëshmi se arsimi për të rritur ka fuqi të madhe për të përmirësuar kompetencat arsimore të njerëzve dhe cilësinë e jetës, duke rritur produktivitetin e tyre të punës, dhe konkurrueshmërinë dhe lëvizshmërinë në tregun e punës.

[1] Henschke, J.A. "Fillimet e Historisë dhe Filozofisë së Andragogjisë 1833-2000". Në *Integrimi i të nxënit të të rriturve dhe teknologjisë për arsim efektiv: qasje strategjike.* Wang, V., [Ed]. IGI Global, Hershey, PA, dhjetor, 2009.

Faktori social. Shoqëria bashkëkohore është një sistem shoqëror kompleks dhe dinamik i karakterizuar me një numër kundërshtish që reflektojnë dukshëm në zhvillimin e arsimit për të rritur. Ne po përballemi me fenomene sociale si: pabarazi sociale dhe ekonomike, rritje të numrit të migrantëve, rol dhe pozitë të ndryshme të grave në shoqëri, rritje të papunësisë, etj. Një nga karakteristikat kryesore të shoqërive moderne është sigurimi që të gjithë kanë të drejtë të barabartë për arsim. Kjo është mënyra e vetme për të shmangur dhe niveluar dallimet klasore dhe ato sociale, për të mbështetur integrimin e grupeve të margjinalizuara dhe të cenueshme dhe të ulet shkalla e papunësisë.

Faktori teknologjik paraqitet me ndryshime të shpejta në shkencë, teknikë dhe teknologji, të cilat kërkojnë përmirësimin e vazhdueshëm të së vjetrës dhe marrjen e kompetencave të reja. Konsiderohet se vetëm fuqia punëtore e arsimuar mirë mund të përshtatet me teknologjitë e reja dhe sfidat që ato sjellin, duke mbajtur dhe përmirësuar produktivitetin e tyre në të njëjtën kohë. Të gjitha sa më lart mund të arrihen përmes arsimit dhe aftësimit bashkëkohor dhe të mirë-organizuar të të rriturve.



Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	Çka është arsimi për të rritur?
Synimi	Hyrje në nocionin "arsimi për të rritur" dhe "andragogji", rrënjët dhe rëndësia e tyre historike, si dhe faktorët që ndikojnë në arsimin për të rritur.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në grup, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	60 min
Burimet e kërkuara	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, shtjellon termat "arsimi për të rritur" dhe "andragogjia", duke e përcaktuar ndryshimin mes tyre. Pastaj parashtron shkurtimisht tre faktorët që ndikojnë në arsimin dhe të nxënit e të rriturve: demografik, social dhe teknologjik. 2. Hapi: Moderimi dhe diskutimi. Mësimdhënësi formon tre grupe të cilave u jepet detyrë të shkruajnë shembuj të përshtatshëm të zbatimeve praktike të formave të të nxënit në fushën e tre faktorëve: demografik, social dhe teknologjik. Secilit grup i jepet një nga faktorët për të shkruar shembuj. 3. Hapi: Prezantimi i punës në grup. Secili grup i prezanton rezultatet e veta para të tjerëve me ndihmën e moderimit të mësimdhënësit.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Puna në dyshe (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);
- Analiza tekstuale dhe dokumentare e përkufizimeve dhe aspekteve të ndryshme të arsimit për të rritur…

1.2 Rëndësia dhe funksionet e arsimit dhe të nxënit të të rriturve

Në shoqërinë bashkëkohore të bazuar në dije, e cila është një sistem shoqëror kompleks dhe dinamik, niveli i ulët arsimor i popullatës është problem thelbësor që pengon zhvillimin dhe përparimin e saj, çka reflektohet në zhvillimin personal të individëve. Kjo është arsyeja pse në letërsinë andragogjike mund të hasim në mendime se zhvillimi shoqëror është i kushtëzuar nga niveli i arsimit të popullatës, pra sa më i lartë niveli i arsimit, aq më e zhvilluar është shoqëria në çdo kuptim (ekonomik, shoqëror, arsimor, etj.).

Vëzhgimi i problemit me arsimin në përgjithësi dhe alfabetizmin e popullatës në botë, dhe raportin përfundimtar të UNESCO-s të vitit 2006 *Arsimi për të gjithë: alfabetizmi për jetën*[2], mund të konkludojmë se niveli arsimor i të rriturve ndikon drejt zhvillimit shoqëror dhe njerëzor në katër kategori: individuale, politike, kulturore dhe sociale.

Zhvillimi individual - përfitimet individuale nga arsimi janë të lidhura me rritjen e fuqizimit të njerëzve[3], emancipimin e tyre, si dhe zhvillimin e mendimit kritik. Këto përfitime individuale nga arsimi paraqesin bazën për përmirësimin e jetës së të rriturve nga aspekti shëndetësor, i planifikimit t; familjes, rritjes së pjesëmarrjes politike dhe qytetare, etj.

Tabela nr. 2: Katër shtyllat e të nxënit sipas UNESCO-s[4]

Të nxënit për të ditur - për të siguruar mjetet kognitive të kërkuara për ta kuptuar më mirë botën dhe kompleksitetet e saj, dhe për të siguruar një bazë të përshtatshme dhe adekuate për të nxënit e ardhshëm.

Të nxënit për të qenë -për të siguruar shkathtësi vetjake analitike dhe sociale që u mundësojnë individëve që të zhvillohen në potencialin e tyre sa më të plotë psiko-social, si nga ana afektive ashtu edhe fizike, për të qenë një person i plotësuar.

Të nxënit për të bërë -për të siguruar shkathtësi që u mundësojnë individëve të marrin pjesë në mënyrë efektive në ekonominë dhe shoqërinë globale.

Të nxënit për të jetuar së bashku: për t'i ekspozuar individët ndaj vlerave të nënkuptuara brenda të drejtave të njeriut, parimeve demokratike, mirëkuptimit ndërkulturor dhe respektit dhe paqes në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe marrëdhëniet njerëzore për t'u mundësuar individëve dhe shoqërive të jetojnë në paqe dhe harmoni.

[2] Më shumë rreth raportit të UNESCO-s në http://www.unesco.org/new/en/unesco/resources/publications/unesdoc-database/

[3] Ka shumë hulumtime të gjera që dëshmojnë për ndikimin pozitiv që ka arsimi në fuqizimin e njerëzve (për shembull programet e alfabetizmit në Brazil, Indi, Nigeri, SHBA, etj.).

[4] Përmbajtja e tabelës është transkriptuar nga UNESCO, (2006), *Arsimi për të gjithë: Dituritë për jetën, Raporti global i monitorimit 2006*, Paris: Botim i Unesco-s.

Zhvillimi shoqëror - Rritja e nivelit të arsimit tek të rriturit ka ndikim pozitiv në arritjen e një numri të aftësive njerëzore, siç janë: kujdesi i duhur për shëndetin e tyre, kontrolli i riprodhimit, të nxënit përmes jetës, rritja e fëmijëve të shëndetshëm, fëmijët më të arsimuar, etj. Andaj, mund të konkludohet se arsimi për të rritur ka përfitime të mëdha sociale të manifestuara përmes rritjes së jetëgjatësisë së të rriturve, uljes së vdekshmërisë tek fëmijët, përmirësimit të gjendjes shëndetësore tek fëmijët dhe të rriturit, etj.

Zhvillimi ekonomik. Përkundër mendimeve kontradiktore në lidhje me marrëdhëniet mes nivelit arsimor të njerëzve dhe zhvillimit ekonomik të shoqërive, ne mund të pajtohemi që ekonomia e sotme është më shumë e bazuar në njohuri sesa në kapital fizik të njerëzve dhe burimeve natyrore. Sa më i lartë është niveli i arsimit, aq më të larta janë shanset për rritje ekonomike. Për më tepër, treguesi më i mirë për rritjen ekonomike të një shoqërie është niveli i arsimit të popullatës së vet, i cili manifestohet përmes shembujve të vendeve shumë të zhvilluara të cilat praktikisht nuk kanë popullsi analfabete.

Në kontekstin e sa më lart, mund të konkludohet se arsimi për të rritur, si reflektim në ndikimet dhe ndryshimet e përgjithshme shoqërore, ekonomike, kulturore, politike, etike dhe psikologjike, ka disa detyra ose funksione themelore. Por, për fat të keq, teoricienët bashkëkohorë nuk pajtohen për klasifikimin e funksioneve themelore të arsimit për të rritur dhe operacionalizimin e tyre, sepse ky problem shpesh paraqet edhe konotacionin ideologjik dhe të vlerës.

Andragogët rusë (Onushkin dhe Ogarev, 1995), tregojnë tre funksione themelore të arsimit dhe të nxënit të të rriturve:

- **Kompensues** - i cili përmbush nevojat dhe mundësitë arsimore të paplotësuara më parë. Ky funksion zakonisht përfshin përpjekje për të zhdukur analfabetizmin mes popullatës, ose disa hendekë arsimorë në arsimin fillor, duke krijuar të rritur që do të jenë funksionalë në shoqëri.
- **Përshtatës** - i cili presupozon përshtatjen me ndryshimet e shpejta të teknologjisë dhe kërkesave të shoqërisë dhe tregut të punës. Ky funksion i referohet përmirësimit të kompetencave ekzistuese të njerëzve ose marrjes së kompetencave të reja sipas kërkesave të parashtruara.
- **Zhvillues** - i cili ka një synim të pasurojë karakteristikat ekzistuese personale dhe profesionale dhe aftësitë e individëve.[5]

[5] Kulic, R., Despotovic, M, D. (2008), *Hyrje në andragogji*, DVV International: Shkup.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	**Rëndësia dhe funksionet e arsimit dhe të nxënit të të rriturve**
Synimi	Të kuptuarit e rëndësisë së arsimit për të rritur (individual, social dhe ekonomik) dhe funksioneve kryesore të arsimit dhe të nxënit të të rriturve: kompensues, përshtatës dhe zhvillues.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, teknika "prizëm"
Korniza kohore	90 min
Burimet e kërkuara	Projektor, fletore, lapsa.
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantime me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi do të përgatisë prezantimin dhe do të shtjellojë funksionet kryesore të arsimit dhe aftësimit të të rriturve dhe rëndësinë e arsimit për të rritur në kuptimin personal, social dhe ekonomik. 2. Hapi: Udhëzime për teknikën "prizëm". Mësimdhënësi jep një fjalë e cila më pas duhet të përshkruhet me dy fjalë të shoqëruara. Dy fjalët e shoqëruara më pas duhet të ndahen në dy fjalë të tjera të shoqëruara dhe kështu me radhë deri në 4 ndarje të fjalëve. Pastaj, nxënësit duhet t'i sintetizojnë fjalët e ndara në fjalë të reja, derisa në fund të marrin një fjalë të fundit. Pastaj, nxënësit do të kenë një detyrë prej gjysmë ore për të shkruar një ese që lidh dy fjalët kryesore (të parën dhe të fundit). 3. Hapi: Vullnetarët do të lexojnë esetë e tyre para të tjerëve.

Grafiku nr. 2: Pamja se si duket teknika "prizmi"



Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Punë në grup (rreth faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në arsimin për të rritur);
- Shkrimi i një eseje për domethënien e arsimit për të rritur.

1.3 Pjesëmarrja aktive në arsimin për të rritur në kontekstin e të nxënit gjatë gjithë jetës

Sistemet arsimore në shumicën e vendeve në të gjithë botën karakterizohen me përshtatje të ngadaltë ndaj zhvillimit të shpejtë të shoqërisë në të gjitha sferat e saj. Arsimi dhe aftësimi i të rriturve është vërejtur si një instrument për zgjidhjen e kërkesave të arsimit fleksibël, i cili mund t'u përgjigjet menjëherë kërkesave të shoqërisë të bazuar në dije dhe nevojave dinamike të tregut të punës, si pjesë e platformës së përgjithshme të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet që individët mësojnë si fëmijë në familje, shkolla, përmes trajnimeve dhe madje edhe universitetet, nuk zgjasin përgjithmonë. Integrimi i sigurt i të nxënit në jetën e një individi të rritur është një aspekt shumë i rëndësishëm për ta bërë realitet konceptin e të nxënit gjatë gjithë jetës, sepse të nxënit gjatë gjithë jetës përfaqëson vazhdim të pafund që zgjat "nga djepi në varr" dhe i cili duhet të rezultojë me aftësimin e individëve për të nxënë dhe për të ndërtuar qëndrim pozitiv ndaj të nxënit në përgjithësi.

Përfundimet nga konventa e Lisbonës konfirmuan që kalimi i suksesshëm drejt ekonomisë dhe shoqërisë së bazuar në njohuri duhet të përfshijë të nxënit gjatë gjithë jetës. Prandaj, sistemet arsimore dhe trajnuese janë thelbi ku duhet të fillojnë ndryshimet për sa i përket transformimit. Të nxënit gjatë gjithë jetës duhet të bëhet parimi udhëheqës në sistemet arsimore dhe trajnuese që përfshijnë të gjitha llojet e ofertave arsimore (formale, joformale dhe informale) të cilat mund të merren në kontekste të ndryshme përgjatë gjithë jetës.

Megjithëse të nxënit gjatë gjithë jetës shihet si një nga instrumentet që së bashku me arsimin për të rritur mund të luftojnë krizën ekonomike, ai paraqet gjithashtu një ideologji e cila duhet të ushqehet që në moshat e hershme të fëmijërisë gjatë gjithë moshës së rritur.

Përmirësimi i kompetencave të individit është gjithashtu thelbësor për ekuitetin, pasi personat e me kualifikim të ulët janë më të cenueshëm në tregun e punës dhe mund të goditen të parët nga kriza. Përmirësimi i shkathtësive dhe kompetencave në konceptin e të nxënit gjatë gjithë jetës nuk është thjesht një luks për punë shumë të kualifikuara të teknologjisë së lartë, por është një domosdoshmëri për të gjithë. Të rriturit me kualifikim të ulët janë shtatë herë më pak të predispozuar të marrin pjesë në të nxënit gjatë gjithë jetës sesa ata me arritje të larta arsimore. Politikat e arsimit, aftësimit dhe punësimit duhet të përqendrohen në rritjen dhe adaptimin e shkathtësive dhe ofrimin e mundësive më të mira të të nxënit në të gjitha nivelet, për të zhvilluar njerëz dhe fuqi punëtore të kualifikuar dhe që i përgjigjet nevojave të ekonomisë.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	**Pjesëmarrja aktive në arsimin për të rritur në kontekstin e të nxënit gjatë gjithë jetës**
Synimi	Prezantimi i rëndësisë së pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur si pjesë e procesit të të nxënit gjatë gjithë jetës.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, punë individuale dhe moderim
Korniza kohore	60 min
Burimet e kërkuara	Projektor, lapsa me ngjyra, fletore ose letra të bardha
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, shtjellon përfitimet nga pjesëmarrja aktive në forma të arsimit për të rritur për individin dhe për shoqërinë në nivel global. 2. Hapi: Mësimdhënësi u jep nxënësve materiale (tekst) të përgatitur në lidhje me përfitimet nga arsimi për të rritur dhe pjesëmarrja në proceset e të nxënit gjatë gjithë jetës. Pastaj u kërkon ta lexojnë me kujdes materialin, duke nënvizuar në tre kolona: ato që dinë, çfarë duan të dinë, dhe çfarë kanë mësuar në fund. 3. Hapi: Prezantimi i punës individuale. Diskutime brenda grupit me moderim nga mësimdhënësi.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Puna në dyshe (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);
- Teknika e mozaikut me përfshirjen e të gjithë nxënësve të ndarë në grupe.

- Për shkak se natyra dhe përmbajtja e kësaj teme janë më shumë teorike, kjo na jep një mundësi për të testuar nxënësit si “praktikues reflektues” duke ofruar një mundësi për të formuluar detyra për të nxënit individual.
- Detyra: analiza e literaturës referente për arsimin për të rritur dhe rëndësinë e tij për individët dhe shoqërinë
- Detyra: Shkrimi i esesë së përgjithshme për këtë temë, duke u konsultuar më parë me mësimdhënësin për literaturën.

Sugjerime për vlerësimin e temës dhe punës individuale

TEMA 2: KONCEPTET KYÇE ANDRAGOGJIKE DHE PEDAGOGJIKE

Tema "konceptet kyçe andragogjike dhe pedagogjike" trajton ndryshimin mes proceseve të të nxënit dhe të mësimdhënies për të rritur dhe fëmijë, si koncepte të ndara. Ajo ka disa nën-tema specifike të cilat janë përqendruar në elemente të ndryshme të Temës kryesore dhe janë paraqitur në Tabelën 3 të Doracakut me përshkrime të synimeve të të nxënit dhe rezultateve të të nxënit. Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe njohurive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënit. Koha optimale për zbatimin e kësaj teme është 1 (një) ditë.

Tabela 3: Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës: **KONCEPTET KYÇE TEORIKE ANDRAGOGJIKE DHE PEDAGOGJIKE**

Synimi i të nxënit të zbatimit të temës: Të kuptuarit e ndryshimit mes koncepteve arsimore pedagogjike dhe andragogjike, si dhe të kuptuarit e ndryshimit mes rrugëve të mësimdhënies dhe të nxënit për të rritur dhe fëmijë. Njohja me terminologjinë bazë arsimore.

Rezultati i përgjithshëm i të nxënit: Pas zbatimit të kësaj teme, nxënësit e dinë ndryshimin mes koncepteve arsimore pedagogjike dhe andragogjike, janë të aftë të përdorin karakteristikat e të nxënit të të rriturve në punën praktike arsimore, si dhe janë të aftë ta përdorin terminologjinë themelore arsimore në aktivitetet e përditshme të mësimdhënies.

Nën-tema	Synimi	Rezultati
1. Të nxënit përkundrejt arsimit	Të kuptuarit e koncepteve të "të nxënit" dhe "arsimit", si dhe dallimet mes tyre.	Nxënësit kuptojnë konceptet e të nxënit dhe arsimit dhe janë të aftë të bëjnë dallimin ndërmjet tyre.
2. Dallimet midis mësimdhënies për fëmijë dhe për të rritur	Të kuptuarit e rrugëve të të nxënit të të rriturve dhe fëmijëve, dhe njohja e dallimeve.	Nxënësit kuptojnë rrugët në të cilat mësojnë të rriturit dhe janë të aftë t'i përdorin në punën e tyre praktike arsimore.
3. Tiparet kyçe të terminologjisë bazë arsimore	Të kuptuarit e terminologjisë bazë në punën arsimore me nxënës të rritur (kompetencat, synimet e të nxënit, rezultatet e të nxënit, kualifikimet, profesionet, etj.)	Nxënësit kuptojnë terminologjinë bazë arsimore dhe janë të aftë ta përdorin në veprimtaritë arsimore të përditshme.

2.1. Të nxënit përkundrejt arsimit

"E vetmja gjë që ndërhyn me të nxënit tim është arsimi im" - Albert Einstein

Për të mbijetuar në jetë dhe punë në botën e sotme të ndryshimit të shpejtë, duhet të mësojmë vazhdimisht. Duke analizuar çka thotë McClasky se "çdo ndryshim kërkon të nxënë të vazhdueshëm" (McClasky, 1974, f.18), mund të shtojmë se çdo mësimnxënie shkakton ndryshim të caktuar i cili na çon në përfundimin se të nxënit dhe ndryshimi janë të ndërlidhur në një rreth magjik (rreth vicioz).

Duket se termi "mësimnxënie" nuk është përdorur kurrë më shumë se sot. Kjo mbështetet në faktin se shkencat kanë përparuar aq shumë sa depozitat e informacionit (të dhëna, fakte, prova, hipotezë, teori) janë një kërcënim për ekzistencën e shkencave. Nuk ka dyshim se çdo gjeneratë di shumë më tepër se ajo e mëparshme. Sidoqoftë, njohuria është e vlefshme vetëm pasi mund ta përdorim në jetën e përditshme, por prapë vlera e dijes është relative sepse varet nga aftësitë dhe mundësitë individuale për ta përvetësuar, menaxhuar, dhe në rrethana të caktuara për ta përdorur atë.

Të nxënit është fenomen themelor njerëzor. Njerëzit mësojnë vazhdimisht, megjithëse nuk janë gjithmonë të vetëdijshëm për këtë. Në gjuhën e përditshme, termi "mësimnxënie" ka të paktën dy kuptime. Kur përmendim të nxënit, ne zakonisht mendojmë për një lloj ndryshimi, njohuri, por edhe sjellje. Megjithatë, gjëja me të cilën ne pothuajse gjithmonë e shoqërojmë të nxënit është pak a shumë ndryshimi i përhershëm që ndodh nga aktiviteti, veprimi, të menduarit ose/dhe ndjenja jonë.

Në një kuptim më të gjerë, **të nxënit** mund të përkufizohet si një *aktivitet që çon në ndryshime*. Qeniet e shëndetshme njerëzore, pa marrë parasysh moshën e tyre, e kanë prirjen për të mësuar, sepse është mënyra e vetme për mbijetesë dhe zhvillim.

Në andragogji, pedagogji, psikologji nuk ka konsensus për përkufizimin e të nxënit. Në përpjekje për ta përkufizuar lirisht, mund të themi se *përfaqëson çdo veprimtari të ndërgjegjshme, të qëllimshme, synimi i të cilës është marrja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të caktuara.*

Në historinë e arsimit, të nxënit shihet gjithmonë përmes prizmit të mësimdhënies dhe shkollimit, i cili është karakteristik për pedagogjinë tradicionale. Sigurisht, ky këndvështrim është i ngushtë dhe i vjetër. Nocioni i të nxënit nuk ka të bëjë me marrjen e njohurive, por me formimin e personalitetit njerëzor.

Arsimi është proces i strukturuar formalisht dhe i urdhëruar në mënyrë hierarkike nga mësimdhënësi/arsimtari, i cili çon në marrjen e diplomës/certifikatës pas përfundimit, si një provë për kompetencat e marra gjatë gjithë procesit arsimor.

Arsimi është term më i ngushtë se të nxënit, sepse jo çdo mësimnxënie është arsim, ndërsa çdo arsim presupozon të nxënit. Të nxënit është një term më i gjerë që përfshin arsimin formal, arsimin joformal dhe të nxënit informal, ndërsa arsimi është karakteristik vetëm për të nxënit formal, dhe disa forma të të nxënit joformal.

Vlerësimi dhe njohja e të nxënit paraprak që është marrë nga sistemi formal ka një rëndësi të madhe për arsimin për të rritur. Kjo i jep vlerë shkathtësive dhe kompetencave të të rriturve, duke i ndihmuar ata të bëhen qytetarë aktivë, konkurrues në tregun e punës, me kompetenca të krijuara mirë personale dhe sociale.

Arsimi formal, arsimi joformal dhe të nxënit informal

Arsimi formal

Termi arsim formal përfaqëson "sistemin e strukturuar në mënyrë hierarkike dhe të renditur në mënyrë kronologjike të institucioneve arsimore, duke filluar nga arsimi fillor, deri në universitet". (Savicevic, 2003, f.233) Sistemi arsimor formal përfshin nivele të ndryshme të arsimit pas mbarimit të nivelit fillestar universitar, si: master, doktoraturë, post-doktoraturë, studime specializimi, etj.

Andragogu i famshëm Amerikan S. Brookfield, si sinonim për arsimin formal përdor termin "të nxënit në rrethana formale" (Brookfield, 1986, f.166), i cili kryesisht kryhet i udhëhequr nga mësimdhënësi, arsimtari, trajneri. Në literaturën arsimore franceze, arsimi formal konsiderohet si "veprimtari arsimore në kuadër të shkollave" (Legendre, 1993, f.28).

Arsimi formal në ditët e sotme është kritikuar shumë për ngurtësinë e tij, lidhjen mësimdhënës-student, rolin pasiv të studentit në procesin e të nxënit, duke mos respektuar nevojat dhe aftësitë e studentit, etj. Për këtë bëhen shumë përpjekje për bashkëkohësimin e arsimit formal duke përdorur metodat dhe teknikat e të nxënit aktiv, si dhe duke përfshirë TIK-un në procesin e mësimdhënies.

Arsimi joformal

Arsimi joformal është bërë forma më e përhapur e të nxënit që po zgjidh problemet me arsimin formal të ngurtë. Ai përkufizohet si "aktivitet arsimor më pak i strukturuar, i orientuar zakonisht drejt arritjes së shkathtësive, fleksibël në afatin kohor, dhe i orientuar drejt arritjes së synimeve të të nxënit" (Radclife dhe Colletta, 1989, f.58). Shprehje të ndryshme përdoren në literaturën andragogjike për të përshkruar arsimin joformal, si: arsim jokonvencional, arsim jotradicional, arsim jashtë shkollës, trajnim, etj.

Teoricienët bashkëkohorë andragogjikë e konsiderojnë arsimin joformal si një aktivitet arsimor të organizuar dhe sistematik drejt aftësimit të të rriturve për punë, aktivitete sociale dhe rritje individuale. Detyrat e arsimit joformal janë të drejtpërdrejta dhe utilitare, për dallim nga arsimi formal, sepse ato burojnë nga nevojat individuale të të nxënit të njerëzve. Ky lloj arsimi karakterizohet nga përdorimi i metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies, të cilat janë kryesisht inovative, dhe në shumicën e rasteve përdor qasjen andragogjike (e orientuar drejt lëndës dhe procesit të të nxënit), për dallim nga qasja pedagogjike (e orientuar drejt përmbajtjes së të nxënit).

Të nxënit informal

Të nxënit informal ka një pjesë dhe rol vendimtar në shoqërinë e bazuar në dije. Ai përfaqëson çdo mësimnxënie jo të planifikuar, aksidentale dhe jo të organizuar me të cilin individët marrin njohuri, shkathtësi dhe qëndrime përgjatë të nxënit nga përvoja në jetën e përditshme. Në literaturën andragogjike, të nxënit informal zakonisht përcaktohet si "proces përgjatë gjithë jetës përmes të cilit individët përvetësojnë qëndrime, shkathtësi dhe njohuri nga përvoja e çdo ditë dhe ndikimi arsimor që rrethon individin" (Radclife dhe Colletta, 1989, f.60). Ky lloj i të nxënit haset gjithashtu si të nxënit

spontan, të nxënit aksidental, të nxënit rastësor, etj., duke theksuar situatën jo të planifikuar dhe aspektin rrethanor të të nxënit.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	**Të nxënit përkundrejt arsimit**
Synimi	Të kuptuarit e koncepteve të "të nxënit" dhe "arsimit", si dhe dallimet mes tyre, si dhe të gjitha format e arsimit dhe të nxënit
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në grup, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	90 min
Burimet e kërkuara	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, shtjellon konceptet e "të nxënit" dhe "arsimit", si dhe ndryshimet mes tyre, si dhe të gjitha format e arsimit dhe të nxënit 2. Hapi: Mësimdhënësi e ndan grupin në tre grupe më të vogla. Secili grup duhet të shkruajë anët pozitive dhe negative për një nga llojet e arsimit dhe të nxënit: formal, joformal dhe informal, si dhe tre shembuj për secilin prej tyre. 3. Hapi: Prezantimi i punës në grup. Secili grup i prezanton rezultatet e veta para të tjerëve me ndihmën e moderimit të mësimdhënësit.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Puna në dyshe (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);
- Analiza tekstuale dhe dokumentare e përkufizimeve dhe aspekteve të ndryshme të të nxënit dhe arsimit…

2.2. Dallimet midis mësimdhënies për fëmijë dhe për të rritur

Kërkesat e reja të paraqitura nga shoqëritë bashkëkohore diktojnë ndryshime në rrugët e të nxënit dhe mësimdhënies. Procesi arsimor nuk mund të bazohet më në metodat dhe teknikat e vjetra të të nxënit dhe mësimdhënies të cilat nuk janë karakteristike për "njerëzit modernë". Ne po përballemi me nevojën për përfshirjen e mediave dhe mjeteve digjitale në procesin e mësimdhënies me "digjitalizimin e mësimdhënies", si dhe për favorizimin e të nxënit në distancë, konferencave online, punëtorive online dhe formave të tjera të mësimdhënies dhe mësimnxënies që theksojnë mungesën e mësimdhënësve dhe përqendrohen në veprimtarinë e studentit dhe të nxënit e drejtuar vetë.

Sa u përket dallimeve mes mësimdhënies dhe të nxënit mes fëmijëve dhe të rriturve, dihet që arsimi për të rritur është i ndryshëm nga arsimi i fëmijëve. Kjo është arsyeja pse mësimdhënia për të rritur nuk mund të reduktohet në të njëjtat metoda, teknika dhe parime si mësimdhënia për fëmijë. Karakteristikat psikologjike, sociale dhe të të nxënit të të rriturve, duhet të jenë baza në të cilën duhet të përqendrohet arsimtari kur zgjedh metodën dhe/ose teknikën e duhur të të nxënit.

Arsimi ndërveprues, i cili është thelbi i procesit të arsimit për të rritur, është përfaqësimi i modelimit didaktik të procesit arsimor ku mbizotëron ndërveprimi mes studentit dhe arsimtarit dhe student-student, duke bërë të mundur që procesi i të nxënit të jetë ndërtimi aktiv i kompetencave për studentët e rritur. Ky lloj i mësimdhënies kërkon kompetenca të larta arsimore dhe didaktike të arsimtarëve për të rritur, me theks të veçantë në dinamikën e grupit dhe metodikën.

Kur bëhet klasifikimi i metodave dhe teknikave të të nxënit, ka kritere të ndryshme që merren parasysh, dhe kjo është arsyeja pse është pothuajse e pamundur të bëhet një përmbledhje e detajuar e diapazonit të pasur të formave, metodave dhe teknikave të të nxënit të të rriturve. Por prapëseprapë ka disa gjëra që arsimtarët për të rritur duhet të kenë parasysh: metodat duhet të jenë të përshtatshme me përmbajtjen e të nxënit, karakteristikat e të nxënit të studentëve, dhe vlerat që promovon procesi arsimor. Në kuptim më të gjerë, metodat dhe teknikat duhet të lidhen me objektivat e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit, ndërsa në një kuptim më të gjerë ato duhet të përqendrohen në realizimin e synimeve të përgjithshme dhe specifike të programit, d.m.th. kompetencat të cilat përshkruhen në programin arsimor.

Kur zgjedh metodën dhe/ose teknikën e duhur, arsimtari për të rritur duhet:

- Të jetë i sigurt që ai/ajo përzgjodhi metodën ose teknikën e duhur të të nxënit;
- Të jetë në gjendje të parashikojë rezultatet e të nxënit duke përdorur metodë/teknikë të caktuar;
- Të jetë i vetëdijshëm për nevojën e njohurive paraprake kur zbaton ndonjë metodë/teknikë;
- Të ketë parasysh kohën, hapësirën dhe materialet e nevojshme për zbatimin e ndonjë metode/teknike;
- Të jetë i sigurt se metoda/teknika është duke siguruar realizimin më efikas dhe ekonomik të objektivit të të nxënit;
- Të jetë i vetëdijshëm se ka shkathtësi dhe aftësi specifike që studenti duhet të zotërojë në mënyrë që të realizojë metodën/teknikën e të nxënit;
- T'i shmangë ato metoda/teknika të të nxënit që shkaktojnë pakënaqësi tek studentët;
- Të jetë elokuent kur jep udhëzime për zbatim të metodës/teknikës së caktuar.

Në mesin e profesionistëve arsimorë ekziston një konsensus në lidhje me atë se ku duhet të përqendrohet procesi i mësimdhënies - zhvillimi i individëve të përgjegjshëm dhe të pavarur, të aftë për vëzhgim kritik dhe vendimmarrje, përgjegjës për rrugët e tyre të të nxënit dhe të karrierës, çka është në përputhje me parimet në të cilat bazohet arsimi për të rritur.

Andragogjia është e përqendruar në:

- Të nxënit, jo mësimdhënien;
- Të nxënit aktiv, jo pasiv;
- Vendosjen e studentit, jo të mësimdhënësit në qendër të procesit të të nxënit;
- Mundësimin e studentëve të marrin përgjegjësinë për të nxënit e tyre;
- Përdorimin praktik të informacionit, jo teorizues.

Ndërsa qasjet tradicionale pedagogjike në mësimdhënie janë:

- mësimdhënësi ka fjalën e fundit;
- mësimdhënësi është qendra e procesit të të nxënit;
- studentët janë vëzhgues pasivë;
- studentëve nuk u lejohet të shprehin mendimin e tyre (sepse nuk është në libër!);
- nevojat dhe aftësitë e studentëve nuk merren parasysh.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	**Dallimet midis mësimdhënies për fëmijë dhe për të rritur**
Synimi	Të kuptuarit e rrugëve të të nxënit të të rriturve dhe fëmijëve, dhe njohja e dallimeve.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në grup, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	90 min
Burimet e kërkuara	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata rreth rrugëve të të nxënit të të rriturve dhe fëmijëve, dhe shprehja e dallimeve mes tyre. 2. Hapi: Teknika e debatit. Mësimdhënësi paraqet një problem, për shembull: Mësimdhënia për të rritur ka ndikim pozitiv në suksesin e të rriturve në arsim. Pastaj mësimdhënësi e ndan grupin në dy grupe: pro dhe kundra. Grupi i parë duhet të mbrojë në mënyrë të argumentuar tezën, dhe grupi tjetër duhet ta kundërshtojë atë me argumente. 3. Hapi: Pas debatit për një periudhë të caktuar kohe, grupet mund të ndërrojnë rolet. 4. Konkluzionet me ndihmën e mësimdhënësit.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Punë në grupe (rreth anëve pozitive dhe negative të mësimdhënies për fëmijë dhe për të rritur);

2.3. Tiparet kyçe të terminologjisë bazë arsimore

Për të realizuar me sukses procesin e mësimdhënies dhe të nxënit, është e nevojshme të njihen termat themelore arsimore që i përkasin terminologjisë arsimore pedagogjike dhe andragogjike, siç janë: kompetencat, synimet e të nxënit, rezultatet e të nxënit, kualifikimi, profesioni, etj.

Rezultatet e të nxënit përcaktohen si deklarata të asaj që një nxënës e di, e kupton dhe është në gjendje ta bëjë pas përfundimit të procesit të të nxënit, të cilat përcaktohen në kuptimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave.

Rezultatet e të nxënit ofrojnë një pasqyrë të qartë dhe transparente të kompetencave të përvetësuara pas realizimit të një programi të caktuar. Ato ofrojnë transparencë, krahasim, njohje dhe transferim të kualifikimeve në institucione të ndryshme arsimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (sistemet e krediteve dhe korniza e kualifikimeve), si dhe në procesin e të nxënit gjatë gjithë jetës.

Standardizimi i kualifikimeve bazuar në propozime të qarta për përvetësimin dhe vlerësimin e *rezultateve të të nxënit* ofron mundësi të gjera për njohjen dhe vlerësimin e të nxënit joformal dhe informal. Ky lloj njohjeje dhe vlerësimi i të nxënit paraprak dhe prej përvojës të përvetësuar përmes rrugës joformale ose informale, bazohet në Sistemin e veçantë (metodologjinë) për akreditimin dhe certifikimin e të nxënit paraprak të përgatitur nga Bordi Kombëtar i Kualifikimeve.

Një **objektiv i të nxënit** është një "deklaratë e asaj që studentët do të jenë në gjendje të bëjnë kur ta kenë përfunduar aftësimin."[6] Objektivat janë:

1. Të lidhura me rezultatet e synuara, JO proceset;
2. Specifike dhe të matshme, JO të gjera dhe të paprekshme;
3. Të përqendruara tek studentët e rritur, JO trajnerët/arsimtarët.

Objektivat e të nxënit zakonisht përfshijnë:

1. **Performanca ose sjellja.** Çka pritet që nxënësi të jetë në gjendje të bëjë ose prodhojë? Kjo pasqyron kompetencat që do të mësohen në aspektin e performancës. Performancat dhe sjelljet duhet të jenë të hapura, të vëzhgueshme dhe të matshme.
2. **Kushtet.** Si do të demonstrohet kompetenca ose njohuria? Kjo mund të përfshijë informacionin specifik që nxënësi duhet të përdorë, ose listimin e mjeteve, referencave ose ndihmave që do të jenë në dispozicion të studentit për demonstrimin e përmbushjes së objektivit.
3. **Kriteri ose shkalla.** Cili grup specifik i kritereve duhet të përmbushet për të demonstruar zotërim? Kjo nënkupton një nivel të performancës.

Si të shkruhen **objektivat e të nxënit**:

1. Përfshini një folje përfunduese dhe të matshme që nënkupton një rezultat të demonstrueshëm të të nxënit.
2. Sigurohuni që secili objektiv të përmbajë një performancë/sjellje të synuar, kushte për të demonstruar kompetencën dhe një kriter/shkallë të performancës.

[6]Arreola, R. (1998), *Shkrimi i objektivave të të nxënit,* University of Tennessee: Memphis.

3. Synoni drejt mendimit më të lartë (nivele të analizës, sintezës dhe vlerësimit) kur është e aplikueshme. Taksonomia e Bloom-it për të shkruarit e objektivave të të nxënit.[7]

Tabela 4: Përshkrimi i taksonomisë foljet e zakonshme të të nxënit

Përshkrimi i taksonomisë foljet e zakonshme të të nxënit	
Njohuri	Për të rikujtuar dhe memorizuar: aranzhoj, përkufizoj, përshkruaj, ekzaminoj, njoh, riprodhoj.
Të kuptuarit	Për të përkthyer nga një formë në një tjetër: klasifikoj, konkludoj, kontrastoj, diferencoj, zbuloj, diskutoj, shpjegoj, deduktoj, parashikoj, lidh, përfaqësoj, përmbledh.
Zbatimi	Për të aplikuar ose përdorur informacion në një situatë të re: administroj, artikuloj, vlerësoj, komputoj, ndërtoj, demonstroj, zhvilloj, themeloj, ekzaminoj, ilustroj, zbatoj, mas, praktikoj, prezantoj, përzgjedh, zgjidh.
Analiza	Për të ekzaminuar një koncept dhe për ta zbërthyer në pjesë: analizoj, shqyrtoj, shoqëroj, karakterizoj, kontrastoj, përcaktoj, diagnostikoj, diskriminoj, përvijoj, prioritizoj, hulumtoj, testoj.
Sinteza	Për të riorganizuar informacionin në një mënyrë unike ose të re për të zgjidhur një problem: përshtas, mbledh, komunikoj, përpiloj, kryej, krijoj, dizajnoj, krijoj, formuloj, përgjithësoj, integroj, performoj, prodhoj, sintetizoj, teorizoj, vërtetoj.
Vlerësimi	Për të bërë gjykime duke përdorur standardet e vlerësimit: argumentoj, përimtoj, krahasoj dhe kontrastoj, kritikoj, mbroj, vlerësoj, interpretoj, justifikoj, vërtetoj, rekomandoj, mbështes, çmoj.

Objektivat e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit janë dy koncepte të ndryshme. **Objektivat e të nxënit** janë të përqendruara në atë që mësimdhënësi duhet t'u mësojë studentëve, kurse **rezultatet e të nxënit** përqendrohen në ato që kanë mësuar studentët në fund të procesit të arsimit. Objektivat e të nxënit janë të orientuara drejt synimit, dhe rezultatet e të nxënit janë të orientuara drejt rezultateve dhe mund të vlerësohen (maten) lehtësisht. Synimi themelor i mësimdhënies dhe të nxënit të të rriturve është të ndryshojë fokusin e arsimit nga arsimtari dhe objektivat e tij, tek studentët dhe arritjet e tyre (rezultatet).

Kur përcaktoni objektivat e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit duhet të keni parasysh se objektivat e të nxënit zakonisht përshkruhen me emrat foljorë (p.sh. përgatitja, drejtimi, udhëzimi, etj.) kurse rezultatet e të nxënit përshkruhen me folje aktive (është i aftë, mund të zhvillojë, etj.)

Kompetencat përcaktohen si aftësia e provuar për të përdorur njohuri, shkathtësi dhe aftësi personale, sociale dhe/ose metodologjike, në punë ose situata studimore dhe në zhvillim profesional dhe personal. Në kontekstin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, kompetenca përshkruhet në kuptim të përgjegjësisë dhe autonomisë.

[7] Po aty.

Sipas përcaktimit të Komisionit Evropian, **kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës** janë një ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të përshtatshme për kontekstin. Ato janë veçanërisht të domosdoshme për përmbushjen dhe zhvillimin personal, përfshirjen sociale, qytetarinë aktive dhe punësimin.[8]

Kompetencat kyçe janë thelbësore në një shoqëri të njohurive dhe garantojnë më shumë fleksibilitet në fuqinë punëtore, duke i lejuar të përshtatet më shpejt me ndryshimet e vazhdueshme në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur. Ato janë gjithashtu një faktor madhor në inovacionin, produktivitetin dhe konkurrueshmërinë, si dhe kontribuojnë në motivimin dhe kënaqësinë e punëtorëve dhe cilësinë e punës.

Janë tetë kompetenca kyçe me përshkrimin e njohurive thelbësore, shkathtësive dhe qëndrimeve që lidhen me secilën prej tyre. Këto kompetenca kyçe janë:

- **komunikimi në gjuhën amtare**, që është aftësia për të shprehur dhe interpretuar koncepte, mendime, ndjenja, fakte dhe mendime si me gojë ashtu edhe me shkrim (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit), dhe ndërveprimi gjuhësor në një mënyrë të përshtatshme dhe krijuese në një gamë të plotë të konteksteve shoqërore dhe kulturore;
- **komunikimi në gjuhë të huaj**, i cili përfshin ndërmjetësimin dhe mirëkuptimin ndërkulturor, përveç dimensioneve kryesore të shkathtësive të komunikimit në gjuhën amtare. Niveli i aftësisë varet nga disa faktorë dhe aftësia për të dëgjuar, folur, lexuar dhe shkruar;
- **kompetencat matematikore dhe kompetencat themelore në shkencë dhe teknologji**. Kompetenca matematikore është aftësia për të zhvilluar dhe zbatuar të menduarit matematikor në mënyrë që të zgjidhen një sërë problemesh në situata të përditshme, me theksin tek procesi, veprimtaria dhe njohuritë. Kompetencat themelore në shkencë dhe teknologji i referohen zotërimit, përdorimit dhe zbatimit të njohurive dhe metodologjive që shpjegojnë botën natyrore. Këto përfshijnë të kuptuarit e ndryshimeve të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore dhe përgjegjësinë e secilit individ si qytetar;
- **kompetenca digjitale** përfshin përdorimin e sigurt dhe kritik të teknologjisë së shoqërisë së informacionit (TSHI), pra shkathtësitë themelore në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK);
- **të nxënit për mësimnxënie** është i lidhur me të nxënit, aftësinë për të ndjekur dhe organizuar të nxënit e drejtuar vetë, individualisht ose në grup, në përputhje me nevojat e vetes, dhe vetëdijesimi për metodat dhe mundësitë;
- **kompetencat sociale dhe qytetare**. Kompetenca sociale u referohet kompetencave personale, ndërnjerëzore dhe ndërkulturore, dhe të gjitha formave të sjelljes që i pajisin individët të marrin pjesë në një mënyrë efektive dhe konstruktive në jetën sociale dhe të punës. Ajo është e lidhur me mirëqenien personale dhe sociale. Është me rëndësi thelbësore të kuptuarit e kodeve të sjelljes dhe zakoneve në mjedise të ndryshme në të cilat veprojnë individët. Kompetenca qytetare, dhe veçanërisht njohja e koncepteve dhe strukturave shoqërore dhe politike

[8] Rekomandimi 2006/962/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i 18 dhjetorit 2006 mbi kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës [Gazeta Zyrtare L 394 e 30.12.2006].

(demokracia, drejtësia, barazia, qytetaria dhe të drejtat civile), i pajis individët që të përfshihen në pjesëmarrje aktive dhe demokratike;

- **ndjenja e iniciativës dhe ndërmarrësisë** është aftësia për t'i kthyer idetë në veprim. Ajo përfshin krijimtarinë, inovacionin dhe marrjen e risqeve, si dhe aftësinë për të planifikuar dhe menaxhuar projekte për të arritur objektivat. Individi është i vetëdijshëm për kontekstin e punës së tij/saj dhe është në gjendje t'i shfrytëzojë mundësitë që lindin. Është themeli për të përvetësuar shkathtësi dhe njohuri më specifike të nevojshme për ata që krijojnë ose kontribuojnë në veprimtari shoqërore ose tregtare. Kjo duhet të përfshijë vetëdijen për vlerat etike dhe të promovojë qeverisje të mirë;
- **vetëdija dhe shprehja kulturore**, e cila përfshin vlerësimin e rëndësisë së shprehjes krijuese të ideve, përvojave dhe emocioneve në një gamë të mediave (muzikë, arte interpretuese, letërsi dhe arte pamore).

Këto kompetenca kyçe janë të gjitha të ndërvarura, dhe theksi në secilin rast vihet në të menduarit kritik, krijimtarinë, iniciativën, zgjidhjen e problemeve, vlerësimin e riskut, marrjen e vendimeve dhe menaxhimin konstruktiv të ndjenjave.[9]

Kompetencat kyçe janë trans-kurrikulare dhe nuk mund të lidhen me lëndë ose module të caktuara. Preferohet të jenë të integruara në çdo modul/lëndë.

Kualifikimi, sipas rekomandimeve të Këshillit Evropian për zhvillimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, nënkupton një rezultat formal të një procesi vlerësimi dhe validimi, i cili merret kur një organ kompetent përcakton që një individ ka arritur rezultate të të nxënit sipas standardeve të dhëna.

Kualifikimi është një term formal për grupe të kompetencave në një nivel, shkallë, profil dhe cilësi të caktuar, dhe vërtetohet me diplomë, ose një formë tjetër certifikate të dhënë nga institucioni i autorizuar. Niveli i kualifikimit paraqet kompleksitetin dhe arritjen e kompetencave të përvetësuara. Ai ka përshkrim të shkurtër të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të përvetësuara, të cilat janë të nevojshme për ekzekutimin e një aktiviteti të caktuar pune.

Kualifikimi jepet me diplomë kur organi/institucioni i autorizuar konfirmon që individi i ka realizuar të gjitha rezultatet e të nxënit sipas standardeve të caktuara. Diploma (ose një formë tjetër e certifikatës) përfaqëson një dokument formal që përfaqëson vlerën e rezultateve të të nxënit në tregun e punës ose/dhe në arsim dhe trajnim.

Kualifikimet mund të merren përmes programeve formale arsimore, kurseve joformale ose të nxënit informal. Duhet të plotësojë kriteret e paraqitura për verifikimin e kualifikimeve, të konsistojë në rezultate të matshme të të nxënit, t'i nënshtrohet vlerësimit me cilësi të siguruar dhe të çojë drejt diplomës/certifikatës.

[9] Po aty.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	Tiparet kyçe të terminologjisë bazë arsimore
Synimi	Të kuptuarit e terminologjisë bazë në punën arsimore me nxënës të rritur (kompetencat, synimet e të nxënit, rezultatet e të nxënit, kualifikimet, profesionet, etj.)
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në grup, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	90 min
Burimet e kërkuara	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, përpunon terminologjinë bazë arsimore. 2. Hapi: Mësimdhënësi formon dy grupe më të gjera, të cilave u jepet detyrë të shkruajnë synimet e të nxënit dhe objektivat e të nxënit për një temë ose kompetencë të caktuar, në përputhje me të nxënit dhe përvojën e tyre të mëparshme. 3. Hapi: Prezantimi i punës në grup. Secili grup i prezanton rezultatet e veta para të tjerëve me ndihmën e moderimit të mësimdhënësit.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Puna në dyshe (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve për terminologjinë bazë arsimore);
- Analiza tekstuale dhe dokumentare e programeve të ndryshme, e cila përfshin synimet e të nxënit, rezultatet e të nxënit, kompetencat, etj.

- Një ide e provimit mund të jetë që nxënësit të bëjnë teste njohurish për tiparet kyçe të temës për terminologjinë arsimore bazë. Kjo është mënyra se si mësimdhënësi mund të marrë njohuri për mënyrën si e kanë kuptuar ata këtë temë.
- Një nga idetë për punë individuale mund të jetë hulumtimi në lidhje me ndryshimet mes arsimit dhe të nxënit, dhe si ndikojnë këto në sistemet e arsimit të sotëm?

Sugjerime për vlerësimin e temës dhe punës individuale

TEMA 3: ARSIMI PËR TË RRITUR NË KONTEKST KOMBËTAR DHE GLOBAL

Tema e tretë është trajtimi i politikave ndërkombëtare të arsimit për të rritur të përshkruara në dokumentet evropiane dhe ndërkombëtare të organizatave referente (UNESCO, OSBE, KE, etj.), i sfidave globale me të cilat përballen arsimi për të rritur dhe shoqëritë bashkëkohore në shekullin XXI, si dhe i kontekstit kombëtar të arsimit për të rritur. Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe njohurive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënit. Koha optimale për zbatimin e kësaj teme është 1 (një) ditë.

Tabela 5: Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës: **ARSIMI PËR TË RRITUR NË KONTEKST KOMBËTAR DHE GLOBAL**

Synimi i të nxënit të zbatimit të temës: Të kuptuarit e politikave evropiane dhe ndërkombëtare për arsimin për të rritur, si dhe arsimi për të rritur në kontekstin e të nxënit gjatë gjithë jetës. Të kuptuarit e sfidave dhe treguesve kryesorë në arsimin për të rritur në nivelin ndërkombëtar. Të kuptuarit e sistemit të arsimit për të rritur në kontekstin kombëtar.

Rezultati i përgjithshëm i të nxënit: Pas zbatimit të kësaj teme, nxënësit i dinë politikat evropiane dhe ndërkombëtare për arsimin për të rritur, janë të aftë të përshkruajnë sfidat dhe treguesit kryesorë në arsimin për të rritur në nivelin ndërkombëtar, dhe të kuptojnë sistemin e arsimit për të rritur në kontekstin kombëtar.

Nën-tema	Synimi	Rezultati
1. Politikat ndërkombëtare të arsimit për të rritur	Të kuptohen politikat evropiane dhe ndërkombëtare për arsimin për të rritur, si dhe arsimi për të rritur në kontekstin e të nxënit gjatë gjithë jetës.	Nxënësit kuptojnë politikat evropiane dhe ndërkombëtare për arsimin për të rritur dhe janë të aftë t'i vëzhgojnë ato në mënyrë kritike.
2. Sfidat dhe treguesit globalë në arsimin për të rritur	Të kuptohen sfidat dhe treguesit kryesorë në arsimin për të rritur në nivelin ndërkombëtar.	Nxënësit kuptojnë sfidat dhe treguesit kryesorë në arsimin për të rritur në nivelin ndërkombëtar dhe janë të aftë t'i zbulojnë ato në nivel kombëtar.
3. Arsimi për të rritur në kontekst kombëtar	Të kuptohet sistemi i arsimit për të rritur në kontekstin kombëtar në lidhje me: legjislacionin, financimin, palët e interesit, përfituesit, stafin e mësimdhënies, sigurimin e cilësisë, etj., si dhe të kuptohet roli i tyre në sistem.	Nxënësit e kuptojnë sistemin e arsimit për të rritur në kontekstin kombëtar në lidhje me legjislacionin, financimin, palët e interesit, përfituesit, stafin e mësimdhënies, sigurimin e cilësisë, etj., dhe janë të aftë të pozicionohen në këtë sistem.

3.1 Politikat ndërkombëtare të arsimit për të rritur

Gjatë dekadave të fundit, arsimi për të rritur ka qenë ndër prioritetet kryesore të politikave evropiane dhe botërore të arsimit. Kjo për shkak të sfidave bashkëkohore të paraqitura nga kriza ekonomike dhe zhvillimi i shpejtë i teknikës dhe teknologjisë që dikton shkathtësi dhe kompetenca të reja mes fuqisë punëtore aktive në tregun e punës. Kriza globale politike dhe ekonomike pritet të vazhdojë të ushtrojë presion shtesë mbi arsimin dhe aftësimin e të rriturve. Përshtatshmëria e të rriturve me aftësi të kufizuara arsimore, ata që humbasin punën e tyre në një mjedis të zvogëlimit të financimit publik dhe privat dhe aftësisë dhe fleksibilitetit të sistemeve arsimore formale për të siguruar kompetenca dhe aftësi të mjaftueshme për lëvizje sociale dhe të punës dhe të nxënit për ata të rinj dhe të rritur që janë dhe/ose ishin në procesin e të nxënit, mbeten sfidat më domethënëse me të cilat përballet arsimi për të rritur.

Krijimi i mundësive për të nxënit e vazhdueshëm për të rriturit dhe përmirësimi i shkathtësive dhe kapaciteteve të tyre është me rëndësi jetike për çdo vend, duke ndikuar në zhvillimin e tij ekonomik, pjesëmarrjen aktive të njerëzve në komunitete dhe shoqërinë civile, ushqimin e mbështetjes dhe respektimit të dialogut kulturor, të krijimtarisë dhe imagjinatës së të rinjve dhe të rriturve, respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit, forcimin e statusit të të nxënit dhe njohurive, dhe ushqimin e vlerave të kulturës së të jetuarit.

Njohja e rëndësisë së jashtëzakonshme të arsimit dhe të nxënit të të rriturve dhe rolit të tij në jetën moderne po bëhet gjithnjë e më e pranishme në strategjitë zhvillimore të vendeve të Bashkimit Evropian, si një përgjigje ndaj rekomandimit të Lisbonës dhe dokumenteve të BE-së.

Strategjia e Lisbonës lidhi tranzicionin e suksesshëm të vendeve drejt ekonomive dhe shoqërive të bazuara në dije, me konceptin e të nxënit gjatë gjithë jetës. Sistemet evropiane të arsimit dhe trajnimit përbëjnë themelet nga duhet të fillojnë ndryshimet, prandaj ata vetë duhet të përshtaten.[10] Si rezultat i iniciativave dhe përvojave të tilla në të gjitha vendet evropiane, Komisioni Evropian miratoi në vitin 2000 gjashtë mesazhe themelore për të shërbyer si një udhërrëfyes në krijimin e programeve zhvillimore për arsimin për të rritur dhe të nxënit gjatë gjithë jetës:

- të garantohet qasje universale dhe e vazhdueshme në mësimnxënie, për të fituar dhe përtërirë shkathtësitë e nevojshme për pjesëmarrje të qëndrueshme në shoqërinë e dijes;
- të rriten në mënyrë të dukshme nivelet e investimeve në burimet njerëzore në mënyrë që t'i jepet prioritet asetit më të rëndësishëm të Evropës - njerëzit e saj;
- të zhvillohen metoda dhe kontekste efektive të mësimdhënies dhe të nxënit për vazhdimin e të nxënit gjatë gjithë jetës dhe për tërë jetën;
- të përmirësohen ndjeshëm mënyrat në të cilat kuptohen dhe vlerësohen pjesëmarrja dhe rezultatet e të nxënit, veçanërisht të nxënit joformal dhe informal;
- të sigurohet që të gjithë mund të përdorin lehtësisht informacion dhe këshilla me cilësi të mirë për mundësitë e të nxënit në të gjithë Evropën dhe gjatë gjithë jetës së tyre;
- të ofrohen mundësi të të nxënit gjatë gjithë jetës sa më afër nxënësve, në komunitetet e tyre dhe të mbështetur përmes lehtësirave të TIK-ut, kudo që të jetë e përshtatshme.[11]

[10] Këshilli Evropian, Lisbonë, 2000

[11] Komisioni Evropian: Një memorandum për të nxënit gjatë gjithë jetës, Bruksel, 30.10.2000

Në Konferencën e Pestë Ndërkombëtare për Arsimin për të Rritur të mbajtur në Hamburg në korrik 1997 (Confintea V), vendet nga e gjithë bota ranë dakord se "vetëm zhvillimi me në qendër njeriun dhe një shoqëri pjesëmarrëse bazuar në respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, do të çojnë në zhvillim të qëndrueshëm dhe të drejtë." Pra, arsimi për të rritur bëhet më shumë sesa thjesht i drejtë; ai përfaqëson çelësin e shekullit të 21-të; një koncept i fuqishëm për mbështetjen e mjedisit të qëndrueshëm dhe promovimin e demokracisë, drejtësisë, barazisë gjinore, si dhe zhvillimit shkencor, shoqëror dhe ekonomik, dhe për krijimin e një bote ku konflikti zëvendësohet me dialog, dhe kultura e paqes mbështetet në drejtësi. Arsimi për të rritur formon identitetin dhe i jep kuptim jetës. Të nxënit gjatë gjithë jetës përfshin ngritjen e pyetjeve për përmbajtjet që mësohen, gjë që reflektohet më tej në faktorë të tillë si mosha, gjinia, aftësia, gjuha, kultura dhe pabarazia ekonomike."[12]

Confintea V përcaktoi synimin e arsimit të të rinjve dhe të rriturve si një proces gjatë gjithë jetës, i cili duhet të zhvillojë autonomi dhe ndjenjën e përgjegjësisë mes njerëzve dhe komuniteteve, në mënyrë që ata të forcohen dhe të jenë të aftë të përballojnë transformimet që ndodhin në ekonomi, kulturë dhe shoqëri në përgjithësi; për të promovuar bashkëjetesën, tolerancën, dhe pjesëmarrjen e informuar dhe krijuese të qytetarëve në komunitetet e tyre; me pak fjalë, për t'u mundësuar njerëzve dhe komuniteteve të kontrollojnë fatin e tyre dhe shoqërinë, në mënyrë që të jenë në gjendje të përballen me sfidat e ardhshme. Është e rëndësishme që qasja ndaj arsimit për të rritur të bazohet në trashëgiminë e njerëzve, kulturën, vlerat dhe përvojat e mëparshme.

Synimi kryesor i CONFINTEA VI e mbajtur në dhjetor 2009 në Belem (Brazil), ishte të harmonizonte të nxënit dhe arsimin për të rritur me agjendat e tjera ndërkombëtare arsimore dhe zhvillimore, dhe integrimin e tyre në strategjitë sektoriale kombëtare, përmes ndjekjes së objektivave të mëposhtëm të konferencës:

- të shtyhet përpara njohja e të nxënit dhe arsimit për të rritur si një element i rëndësishëm dhe faktor i favorshëm për të nxënit gjatë gjithë jetës, themeli i të cilit është alfabetizmi;
- të theksohet roli vendimtar i të nxënit dhe arsimit për të rritur për realizimin e agjendave aktuale ndërkombëtar për arsim dhe zhvillim (EFA, MDG, UNLD, LIFE dhe DESD); dhe
- të përtërihet momentumi dhe angazhimi politik dhe të zhvillohen mjetet për zbatim në mënyrë që të kalohet nga retorika në veprim.

Dokumenti përfundimtar, i njohur si "Korniza e Veprimit e Belemit" përmban rekomandime dhe tregues të konferencës për të matur përparimin drejt realizimit të tyre. Rekomandimet kyçe janë:

(a) të sigurohet që të gjitha anketat dhe mbledhja e të dhënave ta njohin alfabetizmin si vazhdimësi;
(b) të zhvillohet një udhërrëfyes me synime dhe afate të qarta për ta përmbushur këtë sfidë bazuar në vlerësimet kritike të përparimit të bërë, pengesat e hasura dhe dobësitë e identifikuara;
(c) të mobilizohen dhe rriten burimet e brendshme dhe të jashtme dhe ekspertiza për të realizuar programe alfabetizmi në shkallë, gamë, mbulim dhe cilësi më të lartë për të nxitur procese integrale dhe afatmesme, për të siguruar që individët të arrijnë alfabetizëm të qëndrueshëm;

[12] Konferenca e Pestë Ndërkombëtare për Arsimin për të Rritur /Confintea V/, "Të Nxënit e të Rriturve: Një çelës për Shekullin Njëzet e Një", Konferencë e UNESCO-s në bashkëpunim me Partnerë Ndërkombëtarë, Hamburg, Gjermani, 14-18 korrik 1997

(d) të zhvillohet sigurimi i alfabetizmit që është relevant dhe i përshtatur për nevojat e nxënësve dhe çon në njohuri funksionale dhe të qëndrueshme, shkathtësi dhe kompetencë të pjesëmarrësve duke i fuqizuar ata të vazhdojnë si nxënës gjatë gjithë jetës, arritjet e të cilëve njihet përmes metodave dhe instrumenteve të duhura të vlerësimit;
(e) të përqendrohen veprimeve të alfabetizmit ndaj grave dhe popullsive të pafavorizuara, përfshirë popujt indigjenë dhe të burgosurit, me një përqendrim të përgjithshëm te popullsitë rurale;
(f) të përcaktohen treguesit dhe caqet ndërkombëtare për alfabetizmin;
(g) të shqyrtohet dhe raportohet progresi në mënyrë sistematike, ndër të tjera në investimet dhe përshtatshmërinë e burimeve të arsimit në secilin vend dhe në nivelin global, duke përfshirë një seksion të veçantë në Raportin Global të Monitorimit të EFA-s;
(h) të planifikohet dhe zbatohet arsimi, trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i shkathtësive përtej shkathtësive themelore të alfabetizmit të mbështetura nga një mjedis i arsimuar.

Politika e Bashkimit Evropian, përmes zbatimit të Metodës së Koordinimit të Hapur, është dizajnuar si mbështetje ndaj politikave kombëtare në arsimin për të rritur dhe "rregullore" për dizajnin e masave për adresimin e sfidave të përbashkëta, siç janë: mungesat e shkathtësive, mospërputhjet me nevojën për shkathtësi të reja në tregun e punës dhe jetën në përgjithësi, kualifikimet, konkurrenca e tregut, plakja e popullsisë, migrantët, etj.

Rëndësia që BE-ja i jep arsimit për të rritur dhe të nxënit gjatë gjithë jetës mund të shihet më së miri në Strategjinë "Evropa 2020" e cila, përveç të tjerave, përcakton katër synime të përbashkëta që vendet në Evropë duhet t'i trajtojnë dhe t'i arrijnë deri në vitin 2020:

- Të nxënit gjatë gjithë jetës dhe lëvizshmëria të bëhen realitet;
- Të përmirësohet cilësia dhe efikasiteti i arsimit dhe aftësimit;
- Të promovohet barazia, kohezioni social dhe qytetari aktive;
- Të rritet kreativitetin dhe inovacioni, përfshirë ndërmarrësinë, në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit.

Strategjia e re e BE-së përcaktoi edhe standarde specifike që vendet anëtare duhet të arrijnë deri në vitin 2020. Ndër objektivat e tjerë, është përcaktuar se të paktën 15% e të rriturve duhet të marrin pjesë në të nxënit gjatë gjithë jetës, dhe se të paktën 40% e popullatës nga 30 deri në 40 vjeç duhet të kenë kryer një formë të arsimit të lartë.

Konferenca e UNESCO-s e mbajtur në nëntor 2015 në Incheon, Kore, rezultoi me krijimin e Deklaratës së Incheon dhe Kornizës për Veprim për Zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4: ***"Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë."***

Ajo është frymëzuar nga një vizion humanist i arsimit dhe zhvillimit i bazuar në të drejtat dhe dinjitetin e njeriut; drejtësia sociale; përfshirja; mbrojtja; diversiteti kulturor, gjuhësor dhe etnik; dhe përgjegjësia dhe llogaridhënia e përbashkët. Autoritetet arsimore nga vendet e botës riafirmojnë se arsimi është një e mirë publike, një e drejtë themelore e njeriut dhe një bazë për të garantuar realizimin e të drejtave të tjera. Është thelbësor për paqen, tolerancën, përmbushjen e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ata e njohin arsimin si çelës për arritjen e punësimit të plotë dhe zhdukjen e varfërisë. Ata i përqendrojnë

përpjekjet për qasjen, barazinë dhe përfshirjen, cilësinë dhe rezultatet e të nxënit, në kuadër të një qasjeje për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	**Politikat ndërkombëtare të arsimit për të rritur**
Synimi	Të kuptohen politikat evropiane dhe ndërkombëtare për arsimin për të rritur.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në grup, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	90 min
Burimet e kërkuara	Lapsa me ngjyra, projektor, letër ose fletore
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, shtjellon politikat evropiane dhe ndërkombëtare për arsimin për të rritur. 2. Hapi: Mësimdhënësi shtron një tezë rreth pasqyrës së zbatimit të politikave ndërkombëtare dhe evropiane të arsimit për të rritur në kontekstin e tyre kombëtar. Nxënësit shkruajnë një ese për temën e dhënë. 3. Hapi: Prezantimet e eseve. Vullnetarët paraqesin punën e tyre para grupit.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Rrahje mendimesh dhe puna në grup (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve për Temën);
- Analiza tekstuale dhe dokumentare e përkufizimeve dhe aspekteve të ndryshme të politikave ndërkombëtare dhe evropiane të arsimit për të rritur

3.2 Sfidat dhe treguesit globalë në arsimin për të rritur

Deklarata e Incheon dhe Korniza për Veprim për Zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4: ***"Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë"*** u referohet sfidave dhe treguesve kryesorë në arsimin dhe aftësimin e të rriturve në mbarë botën. Përqendrimi është tek përpjekjet për qasjen, barazinë dhe përfshirjen, cilësinë dhe rezultatet e të nxënit, në kuadër të një qasjeje për të nxënit gjatë gjithë jetës.

- **Zgjerimi i qasjes në arsim.** Të sigurohet ofrimi i 12 viteve të arsimit fillor dhe të mesëm falas, të financuar nga publiku, me cilësi të barabartë, prej të cilave të paktën nëntë vjet janë të detyrueshëm, duke çuar në rezultate përkatëse të të nxënit. Ne gjithashtu inkurajojmë ofrimin e të paktën një viti edukimi parafillor cilësor falas dhe të detyrueshëm dhe që të gjithë fëmijët të kenë qasje në zhvillimin, kujdesin dhe edukimin cilësor të fëmijërisë së hershme. Ata zotohen edhe të ofrojnë mundësi arsimi dhe trajnim domethënës për popullatën e gjerë të fëmijëve dhe adoleshentëve jashtë shkollës, të cilët kërkojnë veprim të menjëhershëm, të targetuar dhe të qëndrueshëm, duke siguruar që të gjithë fëmijët janë në shkollë dhe po mësojnë.[13]
- **Përfshirja dhe ekuiteti** në dhe përmes arsimit është gurthemeli i një agjende transformuese arsimore, dhe për këtë arsye ne angazhohemi të adresojmë të gjitha format e përjashtimit dhe margjinalizimit, çekuilibrat dhe pabarazitë në qasje, pjesëmarrje dhe rezultate të të nxënit. Asnjë cak arsimor nuk duhet të konsiderohet i përmbushur nëse nuk plotësohet nga të gjithë. Prandaj, ne zotohemi të bëjmë ndryshimet e nevojshme në politikat arsimore dhe t'i përqendrojmë përpjekjet tona tek më të pafavorizuarit, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara, për të siguruar që askush të mos mbetet pas.[14]
- Ne e kuptojmë rëndësinë e **barazisë gjinore** në arritjen e së drejtës për arsim për të gjithë. Prandaj, ne jemi të përkushtuar të mbështesim politikat, planifikimin dhe mjedisin e të nxënit të ndjeshëm ndaj gjinisë; përfshirjen e çështjeve gjinore në aftësimin e mësimdhënësve dhe kurrikulat; dhe eliminimin e diskriminimit dhe dhunës bazuar në gjini në shkolla.[15]
- Ne zotohemi për **arsim cilësor** dhe për përmirësimin e rezultateve të të nxënit, që kërkon forcimin e inputeve, proceseve dhe vlerësimit të rezultateve dhe mekanizmave për të matur progresin. Ne do të sigurojmë që mësimdhënësit dhe arsimtarët të jenë të fuqizuar, të rekrutuar në mënyrë të duhur, të trajnuar mirë, të kualifikuar profesionalisht, të motivuar dhe të mbështetur në kuadër të sistemeve me burime të mira, efikase dhe të qeverisura në mënyrë efektive. Arsimi cilësor nxit kreativitetin dhe njohurinë, dhe siguron përvetësimin e shkathtësive themelore të alfabetizmit dhe njohurive aritmetike, si dhe shkathtësive analitike, për zgjidhjen e problemeve, dhe shkathtësive të tjera kognitive, ndërnjerëzore dhe shoqërore. Ai gjithashtu zhvillon shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që u mundësojnë qytetarëve të bëjnë jetë të

[13] Deklarata e Incheon dhe Korniza për Veprim për Zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4: *"Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë"*, UNESCO, 2016.

[14] Po aty.

[15] Po aty.

shëndetshme dhe të përmbushur, të marrin vendime të informuara dhe t'u përgjigjen sfidave lokale dhe globale përmes edukimit për zhvillim të qëndrueshëm (EZHQ) dhe edukimit të qytetarisë globale (EQG). Ne gjithashtu theksojmë rëndësinë e edukimit dhe trajnimit për të drejtat e njeriut në mënyrë që të arrihet agjenda e zhvillimit të qëndrueshëm pas vitit 2015.[16]

- Ne angazhohemi të promovojmë **mundësi të të nxënit gjatë gjithë jetës,** për të gjithë, në të gjitha mjediset dhe në të gjitha nivelet e arsimit. Kjo përfshin qasje të barabartë dhe të rritur në arsim cilësor teknik dhe profesional dhe trajnim dhe arsim të lartë dhe hulumtim, me vëmendjen e duhur ndaj sigurimit të cilësisë. Përveç kësaj, është i rëndësishëm edhe ofrimi i shtigjeve fleksibël të të nxënit, si dhe njohja, validimi dhe akreditimi i njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të fituara përmes arsimit joformal dhe informal. Ne zotohen më tej të sigurojmë që të gjithë të rinjtë dhe të rriturit, veçanërisht vajzat dhe gratë, të arrijnë nivele relevante dhe të njohura të zotësive funksionale të alfabetizmit dhe njohurive aritmetike, dhe të fitojnë shkathtësi jetësore, dhe se u ofrohen mundësi të të nxënit, arsimit dhe aftësimit për të rritur. Ne jemi gjithashtu të përkushtuar për forcimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) duhet të shfrytëzohen për t'i forcuar sistemet arsimore, shpërndarjen e njohurive, qasjen në informacion, të nxënit cilësor dhe efektiv, dhe ofrimin e shërbimeve më efektive.[17]
- Për më tepër, ne vërejmë me shqetësim serioz se, sot, një pjesë e madhe e popullatës botërore jashtë shkollës jeton në zona të prekura nga konflikti, dhe se krizat, dhuna dhe sulmet ndaj institucioneve arsimore, fatkeqësitë natyrore dhe pandemitë vazhdojnë të prishin arsimin dhe zhvillimin global. Ne zotohemi të **zhvillojmë sisteme arsimore më gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme dhe më reziliente** për të përmbushur nevojat e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve në këto kontekste, përfshirë personat e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatët. Ne theksojmë nevojën që arsimi të ofrohet në mjedise të sigurta, mbështetëse dhe të siguruara të të nxënit pa dhunë. Ne rekomandojmë një përgjigje të mjaftueshme ndaj krizës, nga reagimi i emergjencës deri në rimëkëmbje dhe rindërtimi; përgjigje më të koordinuara kombëtare, rajonale dhe globale; dhe zhvillim të kapaciteteve për zvogëlimin dhe zbutjen e gjithanshme të riskut për të siguruar që arsimi mbahet gjatë situatave të konfliktit, emergjencës, pas konfliktit dhe rimëkëmbjes së hershme.[18]

[16] Po aty.

[17] Po aty.

[18] Po aty.

Tabela nr. 6: Treguesit për Objektivin e Zhvillimi të Qëndrueshëm 4: *Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë.*[19]

	4.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsim fillor dhe të mesëm falas, të barabartë dhe cilësor, i cili çon drejt rezultateve relevante dhe efektive të të nxënit
	4.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë të kenë qasje në zhvillimin e hershëm cilësor të fëmijërisë, përkujdesje dhe arsim para-fillor, në mënyrë që të jenë gati për arsimin fillor
	4.3 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e barabartë për të gjitha femrat dhe të gjithë meshkujt në arsim të përballueshëm financiarisht dhe cilësor teknik, profesional dhe tretësor, duke përfshirë universitetin
	4.4 Deri në vitin 2030, të rritet në mënyrë substanciale numri i të rinjve dhe të rriturve me shkathtësi relevante, përfshirë shkathtësitë teknike dhe profesionale, për punësim, punë dinjitoze dhe ndërmarrësi
	4.5 Deri në vitin 2030, të eliminohen pabarazitë gjinore në arsim dhe të sigurohet qasje e barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit profesional për personat e cenueshëm, përfshirë personat me paaftësi, popullsitë indigjene dhe fëmijët në situata të cenueshme
	4.6 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë të rinjtë dhe një pjesë substanciale e të rriturve, burra dhe gra, të arrijnë alfabetizëm dhe njohuri aritmetike
	4.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë nxënësit i përvetësojnë dituritë dhe shkathtësitë e duhura për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirë, ndër të tjera, përmes arsimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe mënyra të qëndrueshme të jetesës, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, promovimin e kulturës së paqes dhe jo dhunës, qytetarinë globale dhe vlerësimin e diversitetit kulturor dhe kontributit të kulturave ndaj zhvillimit të qëndrueshëm
	4.a Të ndërtohen dhe përmirësohen objekte arsimore të ndjeshme ndaj fëmijëve, paaftësive dhe gjinive, si dhe të ofrohen mjedise të të nxënit që janë të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive për të gjithë
	4.b Deri në vitin 2020, të rritet në mënyrë substanciale globalisht numri i bursave të disponueshme për vendet në zhvillim, sidomos vendet më pak të zhvilluara, shtete e vogla ishullore në zhvillim dhe shtete afrikane, për regjistrim në arsim të lartë, përfshirë aftësimin profesional dhe teknologjinë e informimit dhe komunikimit, programe teknike, inxhinierike dhe shkencore, në vendet e zhvilluara dhe vendet e tjera në zhvillim
	4.c Deri në vitin 2030, të rritet në mënyrë substanciale numri i mësimdhënësve të kualifikuar, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar për aftësimin e mësimdhënësve në vendet në zhvillim, sidomos në vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim.

[19] Kjo tabelë është kopjuar nga Deklarata e Incheon dhe Korniza për Veprim për Zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4: *"Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë"*, UNESCO, 2016.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	Sfidat dhe treguesit globalë në arsimin për të rritur
Synimi	Të kuptohen sfidat dhe treguesit kryesorë në arsimin për të rritur në nivelin ndërkombëtar.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në dyshe, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	90 min
Burimet e kërkuara	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, shtjellon sfidat dhe treguesit kryesorë në arsimin për të rritur në nivelin ndërkombëtar. 2. Hapi: Mësimdhënësi formon dyshe (ose nxënësit formojnë dyshe) të cilave u është dhënë detyrë të analizojnë dokumentacionin përkatës të politikave në lidhje me arsimin për të rritur (Deklarata, dokumente strategjikë, dokumente koncepti, etj.) dhe të japin këndvështrimin e tyre kritik për secilin prej tyre. 3. Hapi: Prezantimi i punës në dyshe. Secila dyshe paraqet rezultatet e tyre para të tjerëve me ndihmën e moderimit të mësimdhënësit.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Puna në dyshe (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);
- Analiza tekstuale dhe dokumentare e përkufizimeve dhe aspekteve të ndryshme të arsimit për të rritur…

3.3 Arsimi për të rritur në kontekstin kombëtar

Çdo vend ka mjediset e veta arsimore. Kjo varet nga prioritetet e vendit për zhvillim, si dhe nga historia, tradita dhe aspiratat për të ardhmen. Sistemet arsimore në Evropë kanë tendencë të përmbushin prioritetet e përcaktuara në shumë dokumente të politikave të përshkruara në Seksionin 3.1. Arsimi për të rritur, si pjesë e barabartë e sistemit të përgjithshëm arsimor të çdo shoqërie, ka mjedise, legjislacion, politika, prioritete specifike, etj.

Është shumë e rëndësishme që duhet të kuptohen tiparet kryesore të çdo sistemi arsimor për të rritur që për të krijuar një pasqyrë të qartë për rolin e tyre në nënsistemin kombëtar të arsimit për të rritur.

Karakteristikat kryesore të sistemit të arsimit për të rritur janë:

- **Legjislacioni** - Politika dhe dokumentet strategjike (Ligje, Strategji, Dokumente Koncepti, etj.)
- **Infrastruktura e institucioneve publike** - Organet publike, ministritë, qendrat dhe institucionet e tjera që qeverisin, ndihmojnë dhe monitorojnë arsimin për të rritur në nivel kombëtar.
- **Palët e interesit -** Çdo organ i cili është i përfshirë në ofrimin e shërbimeve të arsimit për të rritur (shkolla, universitete, punëtorë dhe universitete qytetare, institucion publik, privat dhe jofitimprurës, kompani, organe, etj.)
- **Përfituesit -**Çdo student mbi 15 vjeç[20] i përfshirë në çdo lloj oferte për arsimin për të rritur në çdo lloj institucioni me çfarëdo forme arsimore (formale, joformale dhe informale).
- **Financimi -** Çdo lloj financimi publik, privat ose i donatorëve me qëllim të mbajtjes dhe përmirësimit të sistemit të arsimit për të rritur.
- **Stafi i mësimdhënies -** Çdo arsimtar, instruktor, trajner dhe andragog i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e arsimit për të rritur.
- **Sistemi për sigurimin e cilësisë -** sistem i strukturuar formalisht për sigurimin e cilësisë së arsimit për të rritur në drejtim të ofertës, infrastrukturës, certifikimit, etj.

[20] Në shumicën e vendeve evropiane, kufiri i moshës për përfshirje në sistemin e arsimit për të rritur është 15-16 vjeç.


Infrastruktura e institucioneve publike
Financimi
Përfituesit
Legjislacioni
Profesionistët e arsimit për të rritur/Stafi i mësimdhënies
Sistemi për sigurimin e cilësisë
Palët e interesit
Arsimi për të rritur

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	Arsimi për të rritur në kontekst kombëtar
Synimi	Të kuptohet sistemi i arsimit për të rritur në kontekstin kombëtar në lidhje me: legjislacionin, financimin, palët e interesit, përfituesit, stafin e mësimdhënies, sigurimin e cilësisë, etj., si dhe të kuptohet roli i tyre në sistem.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në grup, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	90 min
Burimet e kërkuara	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, shtjellon tiparin kyç të çdo sistemi të arsimit për të rritur. 2. Hapi: Mësimdhënësi formon tre grupe të cilave u jepet detyra të bëjnë analiza SWOT (pikat e forta, të dobëta, mundësi dhe kërcënime) për sistemin kombëtar të arsimit për të rritur në vend për sa i përket: legjislacionit, financimit, palëve të interesit, përfituesve, stafit të mësimdhënies, sigurimit të cilësisë, etj. 3. Hapi: Prezantimi i punës në grup. Secili grup i prezanton rezultatet e veta para të tjerëve me ndihmën e moderimit të mësimdhënësit. 4. Hapi: Diskutime rreth rezultateve.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Shkrimi i një eseje (rreth pasqyrës së sistemit kombëtar të arsimit për të rritur);

- Një nga idetë e provimit është zbatimi i testit të njohurive për politikat ndërkombëtare dhe evropiane në arsimin për të rritur
- Një ide interesante mund të jetë gjithashtu t'i kërkoni nxënësve të listojnë dhe të analizojnë sistemin kombëtar të arsimit për të rritur dhe rolin e tyre (ose rolin e ardhshëm) në të.
- Sugjerimet për të nxënit individual mund të jenë analiza e literaturës së rekomanduar ose leximi shtesë i dokumenteve strategjike kombëtare në lidhje me sektorin e arsimit për të rritur.

Sugjerime për vlerësimin e temës dhe punës individuale

TEMA 4: ARSIMI PËR TË RRITUR SI PROFESION DHE ROLI I ARSIMTARIT PËR TË RRITUR

Tema e katërt adreson shumëllojshmërinë e punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur (andragog, menaxher i burimeve njerëzore, punëtor i rritur, trajner, etj.), si dhe kompetencat që posedojnë profesionistët e arsimit për të rritur. Pasi të njihen me sa më lart, nxënësit duhet të jenë në gjendje ta kuptojnë dhe të reflektojnë për rolin e tyre në sistemin e arsimit për të rritur. Kjo temë ka disa nën-tema specifike të cilat janë përqendruar në elemente të ndryshme të Temës kryesore dhe janë paraqitur në Tabelën 5 të Doracakut me përshkrime të synimeve të të nxënit dhe rezultateve të të nxënit. Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe njohurive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënit. Koha optimale për zbatimin e kësaj teme është 1 ditë.

Tabela 7: Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës: **ARSIMI PËR TË RRITUR SI PROFESION DHE ROLI I ARSIMTARIT PËR TË RRITUR**

Synimi i të nxënit të zbatimit të temës: Të kuptuarit e shumëllojshmërisë së punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur, si dhe kompetencat që posedojnë profesionistët e arsimit për të rritur. Pasqyrimi i rolit të nxënësve në sistemin e arsimit për të rritur.

Rezultati i përgjithshëm i të nxënit: Pas zbatimit të kësaj teme, nxënësit do të kuptojnë shumëllojshmërinë e punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur, si dhe kompetencat që posedojnë profesionistët e arsimit për të rritur, dhe do të jenë të aftë të kuptojnë dhe pasqyrojnë rolin e tyre në sistemin e arsimit për të rritur.

Nën-tema	Synimi	Rezultati
1. Arsimi për të rritur si profesion	Të informohemi për shumëllojshmërinë e punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur.	Nxënësit njihen me shumëllojshmërinë e punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur.
2. Kompetencat e arsimtarit për të rritur	Të kuptohet shumëllojshmëria e kompetencave që duhet të posedojë profesionisti i arsimit për të rritur dhe kompetencat e arsimtarit për të rritur sipas Curriculum globALE.	Nxënësit kuptojnë shumëllojshmërinë e kompetencave që duhet të posedojë profesionisti i arsimit për të rritur dhe kompetencat e arsimtarit për të rritur sipas Curriculum globALE, dhe janë në gjendje të reflektojnë për kompetencat e tyre.
3. Reflektime për rolin e vet në arsimin për të rritur	Të kuptohet dhe reflektohet për rolin e tij/saj në sistemin e arsimit për të rritur.	Nxënësit kuptojnë dhe reflektojnë për rolin e tyre në sistemin e arsimit për të rritur.

4.1 Arsimi për të rritur si profesion

Stafi i të nxënit të të rriturve luan një rol kryesor në bërjen realitet të të nxënit gjatë gjithë jetës. Profesionistët e të nxënit të të rriturve u ndihmojnë nxënësve të zhvillojnë njohuri, shkathtësi dhe qëndrime gjatë gjithë jetës së tyre. Në të vërtetë, zhvillimi profesional i njerëzve që punojnë në arsim dhe trajnim është një nga masat thelbësore për të përmirësuar cilësinë e të nxënit në të gjitha nivelet. Studimet e fundit evropiane tregojnë se sektori i të nxënit të të rriturve është shumë i larmishëm. Ky diversitet mund të shihet në grupet e ndryshme të synuara të të nxënit të të rriturve, lëndë të mbuluara nga kurse të të nxënit të të rriturve, por edhe në rrugët profesionale për t'u bërë një profesionist i të nxënit të të rriturve, situatën e punësimit të profesionistëve të të nxënit të të rriturve dhe për më tepër, në kompetencat e kërkuara për të punuar në këtë sektor. Ky diversitet e vështirëson zhvillimin e sektorit në tërësi dhe në veçanti të një profesion të përkushtuar - profesionisti i të nxënit të të rriturve.

Disa vende të Evropës Lindore (Serbia, Maqedonia, Sllovenia) kanë një traditë gati gjysmë shekullore në zhvillimin e arsimit për të rritur si profesion - andragog. Andragogu është një profesionist që punon në të gjitha fushat e arsimit për të rritur. Ky profesion merret pas mbarimit të studimeve pasuniversitare. Vendet e tjera evropiane e kuptojnë ndryshe profesionistin e arsimit për të rritur, si ai që edukon të rriturit (trajner, mësimdhënës, lehtësues, moderator, etj.), profesion i cili mund të merret pasi të keni mbaruar formimin formal ose joformal në nivel universitar dhe/ose pasuniversitar).

Sipas dokumentit *Kompetencat kyçe për profesionistët e të nxënit të të rriturve*, kontributi në zhvillimin e një kornize referimi të kompetencave kyçe për profesionistët e të nxënit të të rriturve, të njohur në kontekstin më të gjerë evropian, përshkruhet si një gamë e gjerë e kompetencave kyçe dhe specifike të profesionistëve të të nxënit të të rriturve[21]:

Kompetencat gjenerike: Këto kompetenca gjenerike janë kompetenca që janë të rëndësishme për kryerjen e të gjitha aktiviteteve në sektorin e të nxënit të të rriturve. Çdo profesionist që punon në sektor duhet t'i ketë këto kompetenca, pavarësisht nëse kryejnë mësimdhënie, menaxhim, këshillim apo veprimtari administrative. Grupi i kompetencave gjenerike përbëhet nga shtatë kompetenca:

1. Kompetenca personale në reflektimin sistematik për praktikën, të nxënit dhe zhvillimin personal të vetes: **të jesh nxënës plotësisht autonom gjatë gjithë jetës**.
2. Kompetenca ndërnjerëzore për të komunikuar dhe bashkëpunuar me nxënës të rritur, kolegë dhe palë të interesit: **të jesh një komunikues, lojtar ekipor dhe rrjetëzues.**
3. Kompetenca për të qenë të vetëdijshëm dhe për të marrë përgjegjësinë për mjedisin institucional në të cilin zhvillohet të nxënit e të rriturve në të gjitha nivelet (instituti, sektori, profesioni si i tillë, dhe shoqëria): **të jesh përgjegjës për zhvillimin e mëtutjeshëm të të nxënit të të rriturve.**
4. Kompetenca për të shfrytëzuar ekspertizën vetanake të lidhur me lëndën dhe burimet e mundshme të të nxënit: **të jesh ekspert.**
5. Kompetencë për përdorimin e metodave, stileve dhe teknikave të ndryshme të të nxënit, përfshirë media të reja, dhe të jesh i vetëdijshëm për mundësitë e reja dhe shkathtësitë elektronike dhe

[21] B.J. Buiskool, S.D. Broek, J.A. van Lakerveld, G.K. Zarifis, M. Osborne, (2010), *Kompetencat kyçe për profesionistët e të nxënit të të rriturve*, Kontributi në zhvillimin e një kornize referimi të kompetencave kyçe për profesionistët e të nxënit të rriturve, Komisioni Evropian: DG EAC.

vlerësimin e tyre në mënyrë kritike: **të jesh në gjendje të përdorësh metoda, stile dhe teknika të ndryshme të të nxënit në punën me të rriturit.**

6. Kompetenca për të fuqizuar nxënësit e rritur për të nxënë dhe mbështetur veten e tyre në zhvillimin e tyre si nxënës plotësisht autonomë gjatë gjithë jetës: **të jesh motivues.**

7. Kompetenca për trajtimin e dinamikës së grupit dhe heterogjenitetit në sfond, nevojave të të nxënit, motivimit dhe përvojës paraprake të nxënësve të rritur: **të jesh në gjendje për t'u marrë me heterogjenitetin dhe grupet.**[22]

Kompetenca specifike: Këto kompetenca specifike janë kompetenca që janë të nevojshme për të realizuar një sërë aktivitetesh. Këto kompetenca janë të nevojshme për profesionistët përgjegjës për një fushë specifike të veprimtarisë (p.sh. lehtësimi i të nxënit, menaxhimi i institutit, etj.). Prandaj, kompetencat specifike nuk kërkohen për të gjithë profesionistët që punojnë në sektorin e të nxënit të të rriturve. Bëhet një dallim mes kompetencave specifike të lidhura drejtpërdrejt me procesin e të nxënit, siç janë mësimdhënia ose këshillimi, dhe kompetencave specifike të lidhura në mënyrë indirekte ose që mbështesin procesin e të nxënit, siç janë menaxhimi dhe mbështetja administrative. Kompetencat, të cilat lidhen drejtpërdrejt me aktivitete specifike të kryera nga profesionistë të të nxënit të të rriturve në procesin e të nxënit, përbëhen nga gjashtë kompetenca të veçanta[23]:

1. Kompetenca për vlerësimin e përvojës paraprake, nevojave të të nxënit, kërkesave, motivimeve dhe dëshirave të nxënësve të rritur: **të jesh në gjendje për të vlerësuar nevojat e të nxënit të të rriturve.**
2. Kompetenca për zgjedhjen e stileve të të nxënit, metodave didaktike dhe përmbajtjes të përshtatshme për procesin e të nxënit të të rriturve: **të jesh në gjendje për të dizajnuar procesin e të nxënit.**
3. Kompetenca për lehtësimin e procesit të të nxënit për nxënësit e rritur: **të jesh lehtësues i njohurive (praktike dhe/ose teorike) dhe stimulues i zhvillimit të vetë nxënësve të rritur.**
4. Kompetenca për ta monitoruar dhe vlerësuar vazhdimisht procesin e të nxënit të të rriturve për ta përmirësuar atë: **të jesh vlerësues i procesit të të nxënit.**
5. Kompetenca për këshillimin për karrierën, jetën, zhvillimin e mëtejshëm dhe, nëse është e nevojshme, përdorimi i ndihmës profesionale: **të jesh këshilltar/këshillues.**
6. Kompetenca për dizajnimin dhe ndërtimin e programeve të studimit: **të jesh zhvillues i programeve**[24]**.**

Janë gjashtë kompetenca specifike shtesë që mbështesin, ose janë indirekt të lidhura me procesin e të nxënit[25]:

7. Kompetenca për administrimin e burimeve financiare dhe vlerësimin e përfitimeve sociale dhe ekonomike të ofertës: **të jesh përgjegjës financiarisht.**
8. Kompetenca për menaxhimin e burimeve njerëzore në një institut të të nxënit të të rriturve: **të jesh menaxher (i njerëzve).**

[22] Po aty.

[23] Po aty.

[24] Po aty.

[25] Po aty.

9. Kompetencë për administrimin dhe udhëheqjen e institutit të të nxënit të të rriturve në përgjithësi dhe administrimin e cilësisë së ofertës së institutit të të nxënit të të rriturve: **të jesh menaxher i përgjithshëm.**
10. Kompetenca në marketing dhe marrëdhëniet me publikun: **të jesh në gjendje të arrish tek grupet e synuara dhe të promovosh institutin.**
11. Kompetenca për trajtimin e çështjeve administrative dhe informimin e nxënësve të rritur dhe profesionistëve të të nxënit të të rriturve: **të jesh mbështetës në çështjet administrative.**
12. Kompetenca për lehtësimin e mjediseve të të nxënit të bazuar në TIK dhe mbështetjen e profesionistëve të të nxënit të të rriturve dhe nxënësve të rritur në përdorimin e këtyre mjediseve të të nxënit: **të jesh lehtësues për TIK[26].**

Të gjitha këto kompetenca nuk duhet të shihen si të domosdoshme për të gjithë profesionistët e të nxënit të të rriturve, përkundrazi, në varësi të pozitës specifike të punës, profesionisti i të nxënit të të rriturve duhet të zhvillojë vetëm kompetencat të cilave u referohet përshkrimi i punës së tij/saj.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	**Arsimi për të rritur si profesion**
Synimi	Të kuptohet shumëllojshmëria e punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në grup, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	60 min
Burimet e kërkuara	Letër tabele, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, shtjellon shumëllojshmërinë e punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur. 2. Hapi: Mësimdhënësi formon dyshe me nxënës të cilave u jepet detyrë të shkruajnë shembujt më të përshtatshëm të të gjitha profesioneve dhe punëve që përfshijnë arsim dhe aftësim të të rriturve. 3. Hapi: Prezantimet e punës në dyshe. Secili grup i prezanton rezultatet e veta para të tjerëve me ndihmën e moderimit të mësimdhënësit.

[26] Po aty.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Puna në grupe (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);
- Analiza tekstuale dhe dokumentare e punëve dhe profesioneve të ndryshme në fushën e arsimit për të rritur…

4.2 Kompetencat e arsimtarit për të rritur

Dinamika bashkëkohore e imponuar në shoqërinë e bazuar në dije paraqet një nevojë të shtuar për profesionistë të arsimit për të rritur nga sektorë të ndryshëm që mund të ndihmojnë të rriturit të pasurojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre për përfshirje në shoqëri dhe qytetari aktive, konkurrencë në tregun e punës dhe vetë-përmbushje. Këta profesionistë duhet padyshim që të zotërojnë disa kompetenca për një punë arsimore me të rritur. Të dhënat dhe përvoja e hulumtimeve tregojnë se suksesi arsimor i të rriturve varet kryesisht nga kompetencat e profesionistëve të arsimit për të rritur.

Ka shumë autorë që po diskutojnë për kompetencat që duhet të zotërojë arsimtari i të rriturve, që dallojnë nga kompetencat për arsimtarët që punojnë me fëmijë, gjë që është rezultat i koncepteve të ndryshme arsimore që kanë pedagogjia dhe andragogjia.

Prandaj, profesionalizimi i arsimit për të rritur perceptohet si një sfidë kyçe në mbarë botën, si në nivelin individual të vendit ashtu edhe në kontekstin ndërkombëtar. *Korniza për Veprim e Belemit* e identifikon profesionalizimin e arsimit për të rritur si një nga sfidat kyçe për këtë fushë dhe shënon: "Mungesa e profesionalizimit dhe mundësive të trajnimit për arsimtarët ka ndikuar dëmshëm në cilësinë e të nxënit dhe sigurimit të arsimit për të rritur (...)" (UNESCO 2009). Rreth një e treta e 150 raporteve të vendeve për arsimin për të rritur të paraqitur në konferencë, përmendin kualifikimin e pamjaftueshëm të personelit si një nga fushat më të mëdha në të cilat duhet të merren veprime (UIL 2009). Si reagim ndaj kësaj situate, ndër të tjera, vendet anëtare të UNESCO-s në konferencën CONFINTEA u angazhuan për "trajnim, ngritje të kapaciteteve, kushteve të punësimit dhe profesionalizim të arsimtarëve për të rritur, p.sh. përmes krijimit të partneriteteve me institucione të arsimit të lartë, shoqatave të mësimdhënësve dhe organizatave të shoqërisë civile" (po aty).

Këto zhvillime formojnë sfondin e përgjithshëm për iniciativën e ndërmarrë së bashku nga Instituti Gjerman për Arsimin për të Rritur - Qendra Leibniz për të nxënit gjatë gjithë jetës (DIE) dhe Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqatës së Qendrave Gjermane të Arsimit për të Rritur (DVV International), për të zhvilluar, provuar dhe shpërndani një kurrikulë bazë për trajnimin e arsimtarëve për të rritur jashtë sektorit të universitetit, e cila duke qenë në përputhje me parimet themelore të arsimit për të rritur, i përmbush standardet ndërkombëtare shkencore dhe është e përshtatshme për t'u përdorur në një shkallë transnacionale. Curriculum globALE është rezultat i kësaj iniciative. Synimi kryesor për të cilin pritet të kontribuojë Curriculum globALE, është i trefishtë[27]:

- të rritet profesionalizimi i arsimtarëve për të rritur duke siguruar një kornizë të përbashkët referimi
- të mbështeten ofruesit e arsimit për të rritur në dizajnimin dhe zbatimin e programeve për trajnim të trajnerëve, dhe
- të nxitet shkëmbimi i njohurive dhe të kuptuarit të ndërsjellë mes arsimtarëve për të rritur në të gjithë botën.

Përdoren posaçërisht shembujt e mëposhtëm:

[27] Avramovska, M., Czerwinski, T., Lattke, S. (2015), *Curriculum globALE*, DVV International, DIE.

- **Certifikata SVEB.** Certifikata e ofruar nga Federata Zvicerane për të Nxënit e të Rriturve (SVEB) është hapi i parë në sistemin modular zviceran për "trajnim të trajnerëve" (Ausbildung der Ausbildenden). Certifikata formon kualifikimin bazë për instruktorët e kursit në arsimin për të rritur, i cili njihet në të gjithë Zvicrën.
- **Certifikata WBA** "Arsimtar i Certifikuar për Rritur": Certifikata përbën të parin nga dy nivelet e kualifikimit për arsimtarët për të rritur në kuadër të Akademisë Austriake të Arsimit të Vazhdueshëm (WBA). WBA është pjesë e sistemit bashkëpunues austriak të arsimit për të rritur të Institutit Federal Austriak për arsimin për të rritur. WBA i përshkruan standarde në formën e një kurrikule. Për ta marrë certifikatën, arsimtarët për të rritur duhet të dëshmojnë se kanë kompetencat e përcaktuara dhe kjo mund të marrë forma të ndryshme. Çdo kompetencë që mungon mund të merret gjithashtu duke ndjekur kurse.
- **Diploma për mësimdhënie në Sektorin e të nxënit gjatë gjithë jetës (DTLLS)**. Në vitin 2007, marrja e një kualifikimi përkatës dhe të akreditуar ishte paraparë me ligj në Angli për mësimdhënësit në sektorin e arsimit të vazhdueshëm të financuar nga publiku. Që nga viti 2007, arsimtarët e rinj për të rritur duhet të kryejnë një kurs themeltar prej 30 orësh në vitin e parë të mësimdhënies. Për të marrë kualifikimin e plotë DTLLS, duhet që brenda 5 viteve të përfundohet një program i gjerë trajnimi modular, i cili mund të kompletohet në bazë të shërbimit brenda 1 deri në 2 viteve. Për t'u akreditуar, programet DTLLS duhet të përputhen me "Standardet Profesionale të LLUK për Mësimdhënësit, Tutorët dhe Trajnerët në sektorin e të nxënit gjatë gjithë jetës", ku përcaktohet korniza e referencës për kompetencat që do të fitohen.

Curriculum GlobALE bazohet në 5 module (përfshirë një modul 0, i cili nuk është i detyrueshëm) me kompetenca të përgjithshme dhe specifike, që nxënësi duhet të marrë pas përfundimit të Programit. Për më tepër, përshkruhen kompetencat e përgjithshme për secilin modul:

Moduli 1: Të qasurit ndaj arsimit për të rritur

Individët që kanë përfunduar Curriculum globALE i dinë dhe kuptojnë funksionet dhe veçantitë e fushës së arsimit për të rritur dhe rëndësinë e saj në kontekstin e tyre shoqëror, gjithashtu në krahasim me kontekstet e tjera të mundshme dhe nën dritën e një kornize më të gjerë ndërkombëtare. Ata janë në gjendje ta pozicionojnë rolin e tyre profesional në këtë kontekst.

Moduli 2: Të nxënit e të rriturve dhe mësimdhënia për të rriturit

Individët që kanë përfunduar Curriculum globALE kanë njohuri për teorinë e të nxënit dhe janë në gjendje ta lidhin këtë me veprimtarinë e tyre didaktike. Ata i njohin veçoritë motivuese, psikologjike dhe sociale të të nxënit të të rriturve dhe i marrin parasysh këto në planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies së tyre.

Moduli 3: Komunikimi dhe dinamika e grupit në arsimin për të rritur

Individët që kanë përfunduar Curriculum globALE i njohin parimet teorike të komunikimit dhe janë në gjendje t'i zbatojnë në mësimdhënie dhe në punën e tyre arsimore me të rriturit. Ata gjithashtu i njohin teoritë kryesore të dinamikës së grupit dhe janë në gjendje ta zbatojnë këtë në veprimtarinë e mësimdhënies/të nxënit në grup, në mënyrë që të drejtojnë proceset shoqërore.

Moduli 4: Metodat e arsimit për të rritur

Individët që kanë përfunduar Curriculum globALE e njohin repertorin e metodave të arsimit për të rritur dhe mund ta zbatojnë për të arritur sukses optimal të të nxënit në grupin përkatës të synuar.

Moduli 5: Planifikimi, organizimi dhe vlerësimi në arsimin për të rritur

Individët që kanë përfunduar Curriculum globALE janë të vetëdijshëm si lidhen me njëra tjetrën fazat e planifikimit (përfshirë zhvillimin e kurrikulës), organizimit, performancës dhe vlerësimit, në ciklin profesional të veprimtarisë së një arsimtari për të rritur. Për fazat e planifikimit, organizimit dhe vlerësimit, ata kanë njohuri për metoda të ndryshme dhe janë në gjendje t'i zbatojnë këto njohuri siç duhet për situatën dhe të reflektojnë në mënyrë kritike për këtë. Kundrejt veprimtarisë së tyre profesionale, arsimtarët për të rritur përdorin përvojën që kanë fituar për t'i përmirësuar sistematikisht programet e tyre.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	**Kompetencat e arsimtarit për të rritur**
Synimi	Të kuptohet shumëllojshmëria e kompetencave që duhet të posedojë profesionisti i arsimit për të rritur dhe kompetencat e arsimtarit për të rritur sipas Curriculum globALE.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna në grup, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	90 min
Burimet e kërkuara	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, shtjellon shumëllojshmërinë e kompetencave që duhet të posedojnë profesionistët e arsimit për të rritur dhe kompetencat e arsimtarit për të rritur sipas Curriculum globALE. 2. Hapi: Mësimdhënësi e ndan grupin në pesë grupe më të vogla, të cilave u jepet detyrë të shkruajnë kompetenca specifike të arsimtarëve për të rritur, sipas secilit prej moduleve të Curriculum globALE (nga 1-5), duke u dhënë kompetencat e përgjithshme të secilit Modul. 3. Hapi: Prezantimi i punës në grup. Secili grup i prezanton rezultatet e veta para të tjerëve me ndihmën e moderimit të mësimdhënësit. 4. Hapi: diskutime rreth punës në grup.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Puna në dyshe (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);
- Analiza tekstuale dhe dokumentare e përkufizimeve dhe aspekteve të ndryshme të arsimit për të rritur…

4.3 Reflektime për rolin e vet në arsimin për të rritur

Pasi të njiheni me tiparet themelore të sistemit të arsimit për të rritur, si dhe me kompetencat që duhet të zotërojnë profesionistët e të nxënit të të rriturve, çdo pjesëmarrës në trajnimin e Curriculum globALE duhet të jetë në gjendje ta lokalizojë vendin e vet në sistem sipas përvojës së punës, aftësive dhe kompetencave të tyre.

Çdo individ ka rolin dhe kontributin e vet në sistemin e arsimit për të rritur, roli i arsimtarit për të rritur është t'u ndihmojë pjesëmarrësve në trajnim që ta gjejnë atë rol dhe kontribut.

Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:

Nën-tema	**Reflektime për rolin e vet në arsimin për të rritur**
Synimi	Të kuptohet dhe reflektohet për rolin e tij/saj në sistemin e arsimit për të rritur.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, puna individuale, moderimi dhe prezantimet
Korniza kohore	120 min
Burimet e kërkuara	lapsa me ngjyra, projektor, letër
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	1. Hapi: Ligjërata. Mësimdhënësi, bazuar në prezantimin e përgatitur, u ndihmon nxënësve të kuptojnë dhe reflektojnë për rolin e tyre në sistemin e arsimit për të rritur. 2. Hapi: Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të shkruajnë një ese në lidhje me reflektimin për rolin, punën dhe kontributin e tyre në sistemin e arsimit për të rritur. 3. Hapi: Prezantimet e eseve. Vullnetarët i paraqesin esetë e tyre para grupit.

Sugjerime didaktike

Kjo nën-temë e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

- Puna në dyshe (e cila rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);
- Të nxënit e drejtuar vetë dhe reflektim rreth rolit të nxënësit në sistemin e arsimit për të rritur.

•Sa u përket specifikave të kësaj teme, mësimdhënësi mund të përdorë llojeve të ndryshme të pyetjeve të provimit, si:

•*Cilat janë kompetencat që duhet të zotërojë arsimtari për të rritur?*

•*Cilat punë dhe profesione i përfshin fusha e arsimit për të rritur?*

•Puna individuale mund të orientohet drejt:

• *Të nxënit për përvojat e ndryshme nga vendet me trajnime të zhvilluara për arsimtarët për të rritur, përmes mjeteve të ndryshme didaktike; ose*

• *Shkrimi i CV-së duke treguar kompetencat e tyre si arsimtarë të të rriturve.*

Sugjerime për vlerësimin e temës dhe punës individuale

Literatura e përdorur dhe e rekomanduar

1. Arreola, R. (1998), *Shkrimi i objektivave të të nxënit,* University of Tennessee: Memphis.
2. Avramovska, M., Czerwinski, T., Lattke, S.(2015), *Curriculum globALE*, DVV International, DIE.
3. B.J. Buiskool, S.D. Broek, J.A. van Lakerveld, G.K. Zarifis, M. Osborne, (2010), *Kompetencat kyçe për profesionistët e të nxënit të të rriturve*, Kontributi në zhvillimin e një kornize referimi të kompetencave kyçe për profesionistët e të nxënit të rriturve, Komisioni Evropian: DG EAC.
4. Brookfield, S. D. (1986), *Të kuptuarit dhe lehtësuarit e të nxënit të të rriturve*, San Francisco: Jossey-Bass.
5. Brosnan, K. (2006), *Objektivat e të nxënit dhe edukimi zhvillimor,* Skoci: University of Stirling.
6. Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2000), *Dokument Pune i Stafit të Komisionit:* Një memorandum për të nxënit gjatë gjithë jetës*,* Bruksel: Komisioni i Komuniteteve Evropiane
7. Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2005), *Rekomandimi i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit mbi kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës,* Londër: Komisioni i Komuniteteve Evropiane
8. Këshilli Evropian, Lisbonë, 2000
9. Konferenca e Pestë Ndërkombëtare për Arsimin për të Rritur /Confintea V/, "Të Nxënit e të Rriturve: Një çelës për Shekullin Njëzet e Një", Konferencë e UNESCO-s në bashkëpunim me Partnerë Ndërkombëtarë, Hamburg, Gjermani, 14-18 korrik 1997
10. Freire, P. (1993), *Pedagogjia e të shtypurve*, Londër: Pengiun Books.
11. Henschke, J.A. "Fillimet e Historisë dhe Filozofisë së Andragogjisë 1833-2000". Në *Integrimi i të nxënit të të rriturve dhe teknologjisë për arsim efektiv: qasje strategjike.* Wang, V., [Ed]. IGI Global, Hershey, PA, dhjetor, 2009.
12. Hiemstra, R. (1996), Të nxënit e vetë-drejtuar të të rriturve, Oxford: Pergamon Press.
13. Hilgard, E. (1966), *Teoritë e të Nxënit*, New York: Appleton-Century-Crofts.
14. Deklarata e Incheon dhe Korniza për Veprim për Zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4: *"Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë"*, UNESCO, 2016.
15. Jarvis, P. (1995), *Teoria dhe praktika e arsimit për të rritur dhe të vazhdueshëm*, Londër: Routledge.
16. Jarvis, P. (2001), *Epoka e të nxënit: shoqëria e edukimit dhe njohurisë,* Londër: Kogan Page.
17. Knowles, M.S. (1990), Nxënësi i rritur: specie e neglizhuar, Houston: Gulf Publishing Company.
18. Kulic, R., Despotovic, M, D. (2008), *Hyrje në andragogji*, DVV International: Shkup.
19. Rekomandimi 2006/962/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i 18 dhjetorit 2006 mbi kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës [Gazeta Zyrtare L 394 e 30.12.2006].
20. Rogers, A. (2005), *Mësimdhënia për të rritur: Edicioni i tretë*, Philadelphia: Open University Press.
21. Rogers, J. (2006), *Të nxënit e të rriturve: Edicioni i katërt*, Philadelphia: Open University Press.
22. Savičevič, D. (2000), *Koreni i razvoj andragoških ideja,* Beograd: Institut za pedagogiju i andragogiju Andragoško društvo Srbije.
23. UNESCO, (2006), *Arsim për të gjithë: Dituritë për jetën, Raporti global i monitorimit 2006*, Paris: Botim i Unesco-s.
24. http://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/